BASHKIA FUSHË-ARRËZ



PLANI STRATEGJIK
I ZHVILLIMIT
TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ

BASHKIA FUSHË ARRËZ

PLANI STRATEGJIK
I ZHVILLIMIT
TË BASHKISË FUSHË ARRËZ

Përgatitur nga: BASHKIA FUSHË ARRËZ

Mbështetur nga: Intercooperation Albania, Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor (dldp)
Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, ShqipëriURBAPLAN, Zvicer

Financuar nga: SDC – Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Fushë Arrëz - 2008

Realizimi Grafik: CREOstd

Shtypur në: Botime AFROJDIT

inter cooperation
Natural Resource Management
Rural Economy
Local Governance and Civil Society

dldp
decentralisation and local development programme

Co-PLAN
INSTITUTE FOR HABITAT DEVELOPMENT
INSTITUTI PER ZHVILLIMIN E HABITATIT

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Condeferazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Albania

Tabela e Përmbajtjes

FJALA E PËRSHËNDETJES 5

MIRËNJOHJE 7

HYRJE 9

KAPITULLI I

Struktura e Përgjithshme 13
1.1 Çfarë është dhe çfarë përfaqëson ky Planin Strategjik Zhvillimi për Bashkinë Fushë-Arrëz? 13
1.2 Nevoja për një Plani Strategjik Zhvillimi në Fushë-Arrëz 13
1.3 Parimet dhe Objektivat e Planit Strategjik të Zhvillimi të Bashkisë Fushë-Arrëz 14
1.4 Metodologjia e Hartimit të PSZh-së 15
1.5 Pjesëmarrja e grupit të Qytetarëve 15
1.6 Struktura e Dokumentit të Strategjisë së Zhvillimit 16
1.7 Zbatimi i PSZh-së për Bashkinë Fushë-Arrëz 17

KAPITULLI II

Përmbledhje e Profilit-Bashkia Fushë-Arrëz 21
2.1 Konteksti dhe Bashkëpunimi Rajonal 22
2.2 Demografia dhe Parashikimet e Popullsisë 23
2.3 Ekonomia 25
2.4 Financat Bashkiake 26
2.5 Shërbimet dhe Infrastrukturat Publike 30
2.5.1 Furnizimi me ujë dhe Kanalizimet e ujërave të zeza dhe të bardha 30
2.5.2 Rrjeti Rrugor / Infrastruktura rrugore 32
2.5.3 Transporti Publik 32
2.5.4 Mbeturinat Urbane 32
2.5.5 Arsimi dhe Kultura 33
2.5.6 Shëndeti Publik 34
2.5.7 Mjedisi 34
2.5.8 Strehimi 35
2.5.9 Struktura Hapësinore 35

KAPITULLI III

Zhvillimi i Propozuar i Bashkisë Fushë-Arrëz 39
3.1 Vizioni i Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz 39
3.2 Parimet dhe Objektivat e Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz 40
3.3 Drejtimet e Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz sipas Vlerësimit të Komunitetit Lokal 41
3.4 Objektivat e përgjithshëm të zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz 42

3.5 Rezultatet e Pritshme dhe Veprimet e Propozuara 43
3.5.1 Objektivi A. Zhvillimi ekonomik i Bashkisë Fushë-Arrëz 43
3.5.2 Objektivi B - Menaxhimi i Tokës 44
3.5.3 Objektivi C. - Përmirësimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve Publike 50
3.5.4 Objektivi D. - Qeverisja e Mirë Vendore 53
3.5.5 Objektivi F. Mobilizimi i Burimeve Financiare dhe Rritje e të Ardhurave 53

KAPITULLI IV

Zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit të propozuar për Bashkinë Fushë-Arrëz 59
4.1. Ndërhyrjet Institucionale të Propozuara 59
4.2. Plani i Veprimit - Bashkia Fushë-Arrëz 60
4.2.1. Plani i Veprimit – Viti 2008 60
4.2.2. Plani i Veprimit – Viti 2009 61
4.2.3. Plani i Veprimit – Viti 2010 63
4.2.4. Plani i Veprimit – Viti 2011 66
4.2.5. Plani i Veprimit – Viti 2012 69
4.2.6. Plani i Veprimit – Viti 2013 71
4.2.7. Plani i Veprimit – Viti 2014 73
4.3. Skema e Monitorimit dhe Treguesit Përkatës 75

Fjala e Përshëndetjes

Ndryshimet e mëdha e të shumta politike, ekonomike dhe shoqërore që pasuan pas lëvizjeve demokratike të viteve 1990 në vendin tonë kanë dhënë një efekt të ndjeshem dhe të dukshëm edhe në Bashkinë Fushë Arrëz, në drejtim te menaxhimit të pushteteve dhe sistemeve të reja të krijuara.

Si pasojë e këtyre ndryshimeve ekonomike e social-kulturore u bë e domosdoshme gjetja e formave dhe mënyrave të reja të drejtimit dhe menaxhimit të institucionit të Bashkisë, si autoriteti më afër qytetarit.

Per t'ju përgjigjur sfidave te reja te zhvillimit, Bashkia Fushë-Arrëz, nepermjet mbështetjes së Intercoorperation Albania me qendër në Shkodër, financimit të Qeverisë Zvicerane, si dhe të orientuar me profesionalizëm dhe përkushtim nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, ka finalizuar me sukses dokumentin e Planit Strategjik të Zhvillimit.

Ky Plan është dhe do të mbetet një dokument shumë i rëndësishëm në duart e qytetarëve të Fushë Arrëzit, të bizneseve dhe në mënyrë të veçantë të Këshillit Bashkiak dhe administratës vendore, për t'u orientuar në të ardhmen në hartimin e buxheteve, përcaktimin e prioriteteve dhe mbështetjen ndaj bizneseve, drejt sfidave dhe zhvillimeve të reja. Në këtë dokument janë analizuar kushtet aktuale, mundësitë e zhvillimit dhe masat që duhet të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen ekonomike, sociale dhe infrastrukturat e nevojshme në Bashkinë Fushë-Arrëz.

Hartimi i këtij Plani Strategjik Zhvillimi për Bashkinë Fushë-Arrëz do të shërbejë si dokument bazë dhe si pikënisje në rrugën e gjatë të zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë, jetës shoqërore dhe ambientit në zonën tonë dhe më gjerë.

Gjej rastin të falenderoj përzemërsisht grupin qytetar, intelektualët, këshilltarët dhe administratën që punuan afërsisht një vit për hartimin e Planit, duke hedhur idetë dhe mendimet e tyre për mundësitë e zhvillimit të zonës. Nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me njëri-tjetrin dhe me Co-PLAN u bë e mundur përgatitja e këtij dokumenti që është i pari në llojin e vet dhe do të shërbejë për krahasimin dhe monitorimin e zhvillimit të zonës sonë gjatë viteve.

Me respekt!

NDUE PALUCA
Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz

Mirënjohje

Ky dokument vjen si rezultat i një pune të përbashkët midis grupit të punës të Bashkisë Fushë-Arrëz, grupit të ekspertëve të Co-PLAN (Instituti për Zhvillimin e Habitatit), ekspertëve të Intercooperation Albania me qendër në Shkodër, si edhe Urbaplan, Zvicër.

Në mënyrë të veçantë, falënderimet i adresohen Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, Z. Ndue Paluca i cili, me përkushtimin dhe këmbënguljen e tij, mundësoi mbarëvajtjen dhe bashkëpunimin e plotë gjatë gjithë procesit të përgatitjes së Planit Strategjik të Zhvillimit. Gjithashtu, falënderime të përzemërta shkojnë në adresë të Grupit të Qytetarëve në qytetin e Fushë-Arrëzit të cilët me pjesëmarrjen, angazhimin e tyre mbresëlënës dhe sugjerimet e tyre dhanë një kontribut të vyer në përgatitjen dhe finalizimin e dokumentit strategjik të zhvillimit të kësaj zone.

Grupi i përbashkët i punës i shpreh mirënjohje të veçantë Intercooperation Albania, i cili në radhë të parë mundësoi përgatitjen e këtij materiali si dhe ofroi një eksperiencë të vlefshme gjatë gjithë procesit.

Pjesëmarrësit kryesorë në këtë proces:

Grupi i Punës në Bashkinë Fushë-Arrëz: Z. Ndue Paluca, Kryetar i Bashkisë Fushë-Arrëz; Z. Gjokë Nikolli, Nënkryetar i Bashkisë; Z. Dritan Lika, Shef i Zyrës së Financës në Bashki; Znj, Flora Bardhoku; Z. Tome Curri.

Përfaqësues të Grupit të Qytetarëve të Bashkisë Fushë-Arrëz: në mënyrë të veçantë falënderojmë Z. Hil Curri, Kryetar i Këshillit Bashkiak, Z. Gjovalin Alia, Z. Fran Hajdari, Z. Dedë Mema, Z. Fadil Beqiri, Znj. Shpresa Mema, Znj. Valbona Gjini, Z. Tonin Matia etj., pa lënë jashtë vëmendjes të gjithë mbështetjen e dhënë nga mbarë qytetaria dhe opinioni publik në këtë Bashki.

Grupi i Co-PLAN: Z. Enton Derraj, Znj. Darina Kokona, Z. Dritan Shutina, Z. Florian Ravoniku, Znj. Elona Saro, Z. Indrit Faja, Znj. Dorina Nikolla, Znj. Rudina Toto.

Intercooperation Albania: Z. Pascal Arnold, Znj, Valbona Karakaçi, Z. Aljon Koçkiq.



Hyrje

Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz paraqitur në këtë dokument vjen në kuadër të **Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (PDZhL)** në Qarkun e Shkodrës.

Bashkia Fushë-Arrëz është një ndër tetë njësitë partnere të qeverisjes vendore përfituese të këtij Programi, krahas Bashkisë Shkodër, Bashkive Vau i Dejës, Pukë, Koplik, dhe Komunave Velipojë, Dajç dhe Guri i Zi.

Ky Program synon drejt përmirësimit të qeverisjes në nivelin vendor, kryesisht përmirësimit të strukturave të menaxhimit dhe administrimit, duke mbështetur proceset e decentralizimit të pushtetit si edhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm për njësitë e zgjedhura lokale nëpërmjet bashkërendimit të zhvillimit urban, mbrojtjes së mjedisit dhe promovimit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.

Hartimi i Planeve Strategjike të Zhvillimit nëpërmjet proceseve përgatitore transparente me pjesëmarrjen e qytetarëve përbën një nga komponentët kryesorë të Programit. Qëllimi i këtij procesi është të pajisë autoritetet vendore përkatëse me një dokument bazë strategjik i cili identifikon prioritetet kyç të zhvillimit për njësinë vendore përfituese si dhe orienton zhvillimin ekonomik, përmirësimin e infrastrukturave fizike dhe sociale, shpërndarjen e shërbimeve publike, planifikimin dhe menaxhimin e territorit etj.

Plani Strategjik i Zhvillimit për Bashkinë Fushë-Arrëz është hartuar dhe përshtatur përgjatë një procesi të hapur, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të drejtorive kryesore në Bashkinë Fushë-Arrëz si dhe të Grupit të Qytetarëve, të cilët janë përfshirë në një cikël seminaresh debatuese dhe procesesh të hapura këshillimore.

Ky proces përfshiu në mënyrë të veçantë anëtarë të stafit të administratës vendore dhe të këshillit bashkiak, përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit (biznesmenë, emigrantë, fermerë etj), përfaqësues të organizatave lokale apo me bazë komunitare në Fushë-Arrëz si edhe partnerë të tjerë që janë duke ushtruar aktivitetin e tyre në territorin e kësaj Bashkie.

Nxitja e pjesëmarrjes së komunitetit, bazuar në forma jodiskriminuese dhe paanshmëri në lidhje me moshën, gjininë, racën, etninë, përkatësinë fetare apo bindjet politike, i ka shërbyer qëllimit për të siguruar legjitimitet dhe konsensus ndërmjet palëve lidhur me Planin, afrimin e komunitetit në vendimmarrje dhe rritjen e nivelit të transparencës së autoriteteve vendore gjatë ushtrimit të detyrave të tyre administrative dhe të shkallës së

Pamje nga procesi i përgatitjes së strategjisë me pjesëmarrjen aktive të qytetarëve vendas – foto-arkiva Co-PLAN 2008





ndërgjegjësimit mbi gamën e shqetësimeve dhe pritshmërive që mbart komuniteti vendas, të gjitha këto si elemente të rëndësishëm për një qeverisje të mirë.

Së fundi, - por jo më pak e rëndësishme - ky dokument do të shërbejë si udhërrëfyesi kryesor për të përcaktuar veprimet dhe marrjen e vendimeve në të ardhmen nga administrata vendore e Bashkisë Fushë-Arrëz. Miratimi i tij në këshillin bashkiak përcakton gjithashtu përgjegjësinë ligjore të stafit të Bashkisë për të përdorur këtë dokument si një orientim strategjik përgjatë hartimit dhe miratimit të buxhetit në nivel vendor si edhe identifikimit dhe bashkërendimit me projekte dhe studime të infrastrukturave apo shërbimeve të ndryshme.



Kapitulli I

STRUKTURA E PËRGJITHSHME

1.1 Çfarë është dhe çfarë përfaqëson ky Plan Strategjik Zhvillimi për Bashkinë Fushë-Arrëz?

Një kuadër i ri orientimi pune: Që prej formimit dhe konsolidimit si Bashki, është hera e parë që administrata vendore në Fushë-Arrëz prodhon strategjinë e saj të zhvillimit, duke shënuar një moment të rëndësishëm që shtron rrugën për një qasje të organizuar dhe të planifikuar të aktiviteteve të saj në të ardhmen.

Procese të Reja: Ky Plan, si një mekanizëm institucional, përcakton agjendën për zhvillimin e ardhshëm të zonës, politikat dhe veprimet e nevojshme për t'u ndërmarrë. Në këtë kuadër, ai nuk është vetëm një produkt por mbi të gjitha një proces që bazohet në nevojat, prioritetet dhe potencialet e identifikuara dhe diskutuara gjatë procesit konsultues me përfaqësuesit kryesorë lokalë.

Një Plan Vizionar i Kombinuar: Praktika e planifikimit në Shqipëri ka njohur kryesisht plane të formës së Masterplaneve, Planeve të Përgjithshëm Rregullues ose dokumenteve strategjikë të zhvillimit (p.sh. strategji zhvillimi të një qyteti apo të një zone të caktuar). Ky Plan Strategjik Zhvillimi është një ndërthurje e elementit strategjik (vizionar) me atë territorial (fizik) dhe administrativ, pra një kombinim objektivash dhe ndërhyrjesh në të gjitha fushat dhe përgjegjësitë që ka qeverisja vendore.

Një paketë/skenar e/i qartë veprimesh: Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz ndërton një kuadër nismash dhe veprimesh konkrete duke përcaktuar aktivitete e duke skeduar përgjegjësitë dhe afatet kohore në nivel vendor. Në këtë mënyrë ajo përkthen përparësitë vendore, mat punën e administratës, vë në dispozicion burimet për të siguruar dhe racionalizuar më tej financimet sipas një kuadri koherent, qartëson dhe përcakton investimet e nevojshme dhe, më e rëndësishmja, mundëson realizimin e pritshmërive të ndryshme.

Një Instrument për Zhvillimin e Territorit: Dokumenti i PSZh-së propozon veprime për identifikimin e formave të përdorimit të tokës si edhe kuadrin rregullues; këto pasqyrojnë orientimin teknik në lidhje me transformimin e infrastrukturave apo modeleve të përdorimit të tokës në të ardhmen.

1.2 Nevoja për një Plan Strategjik Zhvillimi në Fushë-Arrëz

Qëllimi i përgatitjes së këtij Plani Strategjik Zhvillimi është t'i përgjigjet nevojës së ngutshme, të identifikuar nga autoritetet vendore të zgjedhur rishtas në këtë Bashki, për të përmirësuar performancën e tyre gjatë udhëheqjes së ndryshimeve dinamike, si urbane ashtu edhe rurale, që janë duke ndodhur aktualisht në vend pas viteve '90.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006, Bashkia Fushë-Arrëz, si pjesë e 8 njësive të qeverisjes lokale partnere të IC Shqipëri të përfshira në PDZhL, iu nënshtrua një procesi vlerësimi teknik të detajuar, i cili lehtësoi dhe qartësoi nevojat, kërkesat dhe prioritetet kryesore të saj. Si rezultat i këtij vlerësimi të detajuar u evidentua, ndër të tjera, nevoja për një dokument strategjik të zhvillimit vendor.

Kuadri i përgjithshëm ligjor për përgatitjen e këtij Plani Strategji Zhvillimi është ligji organik i pushtetit vendor i cili përcakton, në vija relativisht të përgjithshme, se duke filluar nga viti 2001, Komunat

dhe Bashkitë janë tërësisht përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të tyre, ku përfshihet edhe fusha e zhvillimit ekonomik vendor konkretisht në (i) përgatitjen e programeve të zhvillimit ekonomik vendor dhe (ii) organizimin e shërbimeve në mbështetje të tij si informacioni, struktura dhe infrastruktura përkatëse[1].

Ndërkaq, që prej fillimit të vitit 2007, qeveria shqiptare është duke përshtatur një draft të ri të Ligjit mbi Planifikimin e Territorit. Ligji ekzistues mbi Planifikimin Urban Nr. 8405, 17 Shtator 1998 përcakton se autoritetet vendore janë përgjegjëse për përgatitjen dhe miratimin e planeve të përgjithshëm rregullues për territoret e tyre përkatëse[2]. Këto më pas janë subjekt i miratimit final në qeverinë qendrore. Projekt-ligji mbi planifikimin urban që pritet të miratohet së shpejti parashikon instrumentet kryesore të menaxhimit të territorit si edhe masat për kontrollin e zhvillimit, duke i dhënë qeverisjes vendore fuqi të plotë veprimi për përgatitjen dhe miratimin e strategjive të zhvillimit dhe direktivat përkatëse mbi mjetet e koordinimit midis njësive të ndryshme lokale. Diskutimet mbi draftin e Ligjit të ri për Planifikimin e Territorit i cili pritet të miratohet, nxori në pah nevojën për të përshtatur Planin Strategjik të Zhvillimit me kuadrin e ri ligjor.

Nga ana tjetër, një shtytje e rëndësishme në përforcim të nevojës për pajisjen e Bashkisë Fushë-Arrëz me një dokument zhvillimi vjen gjithashtu edhe nga nismat, propozimet apo idetë e shprehura lidhur me zhvillimin strategjik në Rajonin e Shkodrës. Për këtë arsye, është e nevojshme që ky Plan të analizojë më konkretisht ndikimet e pritshme në zhvillimin e Fushë-Arrëzit dhe të krijojë kushtet e përshtatshme të bashkëpunimit dhe të përfitimit të ndërsjellë prej tyre në të ardhmen.

1.3 Parimet dhe Objektivat e Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz

Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz është bazuar në principet si:

- **Strategjik**, i tillë që të identifikojë ato fusha veprimi afatgjata dhe ndërhyrje konkrete të cilat do të adresojnë nevojat e ngutshme të popullsisë dhe grupeve vendore të interesit, duke i ndërthurur ato me tendencat e zhvillimit në të ardhmen të kësaj Bashkie.

- **I thjeshtë dhe i kuptueshëm**, ku propozimet të jenë të qarta për nivelin e vendimmarrjes dhe administratës vendore, banorët, grupet e popullsisë dhe sipërmarrjen private të qytetit, duke mundësuar njohjen dhe konkretizimin e propozimeve në të gjitha fushat e aktivitetit në Bashkinë Fushë-Arrëz.

- **I përshtatshëm**, që të lejojë krijimin e hapësirave të nevojshme për t'u përshtatur ndaj situatave, nevojave apo zhvillimeve të paparashikuara në të ardhmen në Bashki; dhe njëherazi subjekt i përmirësimit të vazhdueshëm nga ana e autoriteteve, duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të grupeve të interesit.

- **I mundshëm**, i tillë që të bazohet në mundësitë reale të Bashkisë Fushë-Arrëz, nga pikëpamja financiare dhe e burimeve njerëzore, por pa mënjanuar edhe ato ndërhyrje të rëndësishme strategjike të cilat mund të kërkojnë burime përtej kapaciteteve aktuale të Bashkisë.

[1] Ligji Nr. 8652, datë 31.7.2000, "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore*".
[2] Ligji Nr. 8405, datë 17.09.1998 "*Për Urbanistikën*".

- **Transparent**, i tillë që të jetë i hapur me propozimet e tij ndaj të gjithë komunitetit, biznesit dhe grupeve të rëndësishme në Bashkinë Fushë-Arrëz, duke mundësuar kështu rritjen e besueshmërisë në zbatimin e tij dhe rritjen e përgjegjshmërisë së autoriteteve vendore.
- **Aktual**, i tillë që të përputhet me të gjitha strategjitë dhe politikat e tjera të zhvillimit në nivel kombëtar dhe rajonal.

1.4 Metodologjia e Hartimit të PSZh-së

Në metodologjinë e evidentuar për përgatitjen e dokumentit të PSZh-së, fokusi kryesor ishte pjesëmarrja e gjerë e aktorëve vendas. Për rrjedhojë, që në fillesat e projektit, IC Shqipëri dhe Co-PLAN u angazhuan në përcaktimin e një procesi hartimi të përbërë nga 4 faza. Rezultatet e secilës fazë u paraqitën për diskutim me komunitetin vendas dhe Bashkinë.

Bashkia Fushë-Arrëz ngriti një grup pune brenda administratës si Grupi Kryesor i cili punoi ngushtësisht me ekspertët e Co-PLAN për organizimin e gjithë procesit, realizoi procesin e kërkimit dhe mbledhjes së të dhënave si edhe lehtësoi pjesëmarrjen e aktorëve vendorë.

1.5 Pjesëmarrja e "Grupit të Qytetarëve"

Plani, i projektuar si një kontratë mes autoriteteve vendore dhe qytetarëve, imponon parimin e hartimit të PSZh-së në bashkëveprim të ngushtë me qytetarët si një kusht kyç për garantimin e suksesit të mëtejshëm.
Bashkia Fushë-Arrëz evidentoi dhe ngriti një Grup Qytetarësh të përbërë nga 25-30 persona, të cilët u përfshinë në mënyrë aktive në të 4 fazat e përgatitjes së dokumentit.

Seminaret me pjesëmarrje

Bashkëpunimi me Grupin e Qytetarëve Fushë-Arrëz u formalizua nëpërmjet organizimit të 4 seminareve të shpërndara në funksion të çdo faze

Pamje nga takimet me banoret e Fushe-Arrezit





të përgatitjes së dokumentit. Qëllimi i tyre konsistoi në nxitjen dhe lehtësimin e shkëmbimit të ideve apo sugjerimeve ndërmjet vetë qytetarëve por, në të njëjtën kohë, edhe në evidentimin e saktë të gamës së shqetësimeve dhe pritshmërive të komunitetit të Fushë-Arrëzit. Seminaret u ndërtuan në formatin 1-ditor dhe përgjatë tyre u aplikuan metoda të dinamikave të grupit për të rritur rezultatet e pritura.

Shumëllojshmëria e pjesëmarrësve

Grupi i qytetarëve ishte i përbërë nga përfaqësues të të gjithë aktorëve vendorë p.sh.:

- Përfaqësues të të gjithë spektrit politik
- Përfaqësues të sektorëve të ndryshëm operues, biznesmenë etj.
- Përfaqësues të fshatrave
- Burra dhe gra
- Të rinj dhe të moshuar

Larmia e pjesëmarrësve kishte për qëllim sigurimin e një garancie afatgjatë dhe zbatimin me sukses të PSZh-së së propozuar.

Një faktor i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të SZhL-së së Bashkisë Fushë-Arrëz u konsiderua përfshirja konstante e Këshillit Bashkiak. Një pjesë e këtij Këshilli u përfshi gjithashtu në seminaret gjatë përgatitjes së PSZh-së. Për më tepër, kontaktet me Këshillin e Bashkisë u intensifikuan me prezantimet periodike të progresit të projektit përgjatë çdo faze të tij.



1.6 Struktura e Dokumentit të Planit Strategjik të Zhvillimit

Dokumenti në vazhdim është përgatitur duke ruajtur një formë dhe strukturë të thjeshtë dhe të lexueshme, që t'i drejtohet administratës publike, këshillit bashkiak, grupeve këshillimore të qytetarëve, gjithë aktorëve që veprojnë në zonë dhe, mbi të gjitha, donatorëve apo investitorëve të huaj.

Dokumenti i Strategjisë është organizuar dhe ndarë në katër kapituj kryesorë, të përshkruar shkurtimisht në vijim:

Kapitulli i Parë përshkruan kontekstin, rëndësinë dhe konceptet kryesore të dokumentit.

Kapitulli i Dytë, në bazë të informacionit dhe të dhënave të grumbulluara, paraqet një profil të gjendjes aktuale në Bashkinë Fushë-Arrëz nga këndvështrime territoriale, urbane, ekonomike-sociale, mjedisore etj. duke evidentuar potencialet, sfidat dhe prirjet e zhvillimit para dhe pas viteve '90.

Kapitulli i Tretë parashtron një vizion të përgjithshëm të zhvillimit të Bashkisë si dhe përcakton objektivat strategjikë, duke i zbërthyer më tej në nivelin e nismave dhe ndërhyrjeve konkrete të përqendruara në pesë drejtime kryesore: zhvillimi ekonomik, menaxhimi i territorit, shërbimet dhe infrastrukturat, qeverisja e mirë dhe zhvillimi i burimeve financiare të nevojshme për vënien në zbatim të Planit Strategjik të Zhvillimit.

Kapitulli i Katërt i kushtohet zbërthimit më të hollësishëm të përcaktimeve të dala nga Kapitulli i Tretë në plane konkrete veprimi për t'u ndjekur e zbatuar vit pas viti, duke propozuar mekanizma ligjorë dhe institucionalë si edhe një plan vlerësimi dhe monitorimi për çdo hap të ndërmarrë.

1.7 Zbatimi i PSZh-së për Bashkinë Fushë-Arrëz

Rëndësia që iu dha në hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit, marrjes së pronësisë mbi të nga ana e anëtarëve të zgjedhur vendorë, komunitetit apo grupeve të interesit sektorialë, përbën një parakusht dhe hap thelbësor në lehtësimin e zbatimit me efektivitet të këtij Plani.

Që në konceptimin fillestar të metodologjisë me proces pjesëmarrës, të gjithë aktorët vendorë u angazhuan të ndjekin hap pas hapi procesin e zbatimit të PSZh-së në Fushë-Arrëz, duke rritur mundësitë për efikasitet dhe transparencë.

Administrata vendore e Fushë-Arrëzit është aktori kryesor përgjegjës dhe i interesuar për zbatimin e këtij Plani. Ky dokument vjen në një moment të rëndësishëm për autoritetet vendore duke përfshirë, që prej vitit të parë të qeverisjes, periudhën legjislative të zgjedhjeve lokale 2007-2011.



Megjithëse përcaktimet strategjike dhe vizioni i këtij Plani i përmbahen një periudhe kohore afatmesme (afërsisht 10-15 vjet), Plani i Veprimit është menduar për një kohë më afatshkurtër, në përputhje me periudhat legjislative zgjedhore (2009 - 2014), me mundësi për shtrirje të mëtejshme.

Plani Strategjik i Zhvillimit do të jetë subjekt i një rishikimi të hollësishëm, duke marrë parasysh ndryshimet që po ndodhin në Fushë-Arrëz. Si rezultat, procesi i monitorim-vlerësimit është një moment thelbësor në lidhje me ecurinë e zbatimit të PSZh-së, i parë në këndvështrimin e objektivave të arritura dhe gjithashtu të vënies në dispozicion me efektivitet të burimeve.

Sikurse edhe vetë hartimi i Planit, procesi i monitorim-vlerësimit të tij përfshin anëtarët e zgjedhur dhe përfaqësuesit e komunitetit në Fushë-Arrëz të cilët kanë kontribuar që në fazat e para të hartimit të tij.

Procesi i monitorim-vlerësimit do të kryhet çdo vit, duke iu referuar analizës vjetore institucionale dhe procesit të hartimit të buxhetit vjetor bazuar në propozimet konkrete të dhëna në dokumentin e Planit.





Ky proces do të jetë në përshtatje me afatet kohore të vendosura, burimet e vëna në dispozicion dhe buxhetet përkatëse përkrah çdo veprimi të propozuar apo realizuar.

Këshilli vendor i Bashkisë, sipas rrethanave specifike, mund të propozojë, nëpërmjet një vendimi të posaçëm, një monitorim nga jashtë të ecurisë së Planit, nga ekspertë kombëtarë ose ndërkombëtarë, me qëllim forcimin e përgjegjshmërisë dhe rritjen e transparencës në lidhje me dialogun me qytetarët.

Në Këtë mënyrë procesi i monitorim-vlerësimit, si rezultat, do të asistojë autoritetet vendore të Fushë-Arrëzit në matjen e performancës në lidhje me ekzekutimin e funksioneve të tyre dhe ecurinë e përmbushjes së premtimeve zgjedhore për periudhën legjislative gjatë së cilës ata do të qeverisin.

Raporti i monitorimit për Planin Strategjik të Zhvillimit në Bashkinë Fushë-Arrëz do të konsistojë në sa më poshtë:

- Do të sigurojë informacion dhe do të paraqesë prirjet kryesore të zhvillimit në përputhje me profilin e Bashkisë Fushë-Arrëz
- Do të evidentojë efektin e produkteve dhe politikave
- Do të paraqesë ecurinë e arritjes së objektivave dhe të grupeve të synuara (si janë arritur ato, sa janë arritur, deri në çfarë niveli etj.)
- Do të shërbejë si udhërrëfyes për rishikimin e Planit gjatë kohës që ai pëson ndryshime; do të kontrollojë treguesit e përcaktuar si në kohë edhe në buxhet në përqasje me planin e propozuar për zbatim.



Kapitulli II

Profili i Gjendjes Aktuale të Bashkisë Fushë-Arrëz

Përmbledhje e Profilit – Bashkia Fushë-Arrëz


Nr.	Emri	Vlera / karakteristika
1	Statusi Ligjor dhe Administrativ	Bashki
2	Vendndodhja	Qarku Shkodër
3	Sipërfaqja totale	23.6km²
4	Numri i qyteteve	1
5	Numri i fshatrave	2
6	Numri i banorëve	4, 800
7	Numri i familjeve	1175
8	Popullsia në gjendje fizike pune	42%
9	Buxheti Vjetor - 2008	28,439,000 Lekë
10	Të Ardhurat Lokale të Pritshme - 2008	7,500,000 - 8,000,000 Lekë
11	Numri i bizneseve private	80
12	Niveli i papunësisë	30%
13	Numri i të punësuarve në sektorin shtetëror	135
14	Numri i të punësuarve në sektorin privat	Nuk ka të dhëna të sakta
15	Niveli i emigracionit	Nuk ka të dhëna të sakta
16	Gjatësia totale e rrugëve	15km
17	Numri i Ndërmarrjeve Publike	3
18	Numri i rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve	1
19	Numri i të punësuarve në Bashki	17
20	Numri i institucioneve parashkollore	4
21	Numri i shkollave fillore - nëntëvjeçare	3
22	Numri i shkollave të mesme	1
23	Numri total i nxënësve	1300
24	Numri i qendrave shëndetësore	3
25	Numri i spitaleve	0
26	Numri i qendrave të kështillimit	0
27	Numri i qendrave për të moshuar	0
28	Aktivitetet kryesore ekonomike	Prerje dhe përpunim druri
		Nxjerrje mineralesh
		Dyqane dhe njësi tregtare
		Njësi shërbimi dhe servise
		Mbledhje bimësh mjekësore
29	Dokumente zhvillimi dhe strategji	Strategjia e Zhvillimit Rajonal
		Plani i Menaxhimit të Mbeturinave
30	Nevojat kryesore në Infrastrukturë	Përmirësimi i rrjetit të brendshëm të ujësjellës-kanalizimeve
		Ndërtimi i pikës së trajtimit të ujërave të zeza të qytetit
		Përmirësimi i hapësirave të brendshme të qytetit
		Asfaltimi i unazës së qytetit
		Sistemimi i rrugëve të fshatrave
		Rehabilitimi i banesave të braktisura

2.1 Konteksti dhe Bashkëpunimi Rajonal

Konteksti Gjeografik

Fushë-Arrëzi është një Bashki e vogël me rreth 4,800 banorë, në zonën veriperëndimore të Shqipërisë, e cila ndodhet përgjatë rrugës kombëtare Shkodër-Kukës-Prishtinë. Bashkia Fushë-Arrëz bën pjesë në Rrethin e Pukës dhe kufizohet nga verilindja me Kukësin dhe nga jugperëndimi me Pukën; ndërsa brenda Qarkut kufizohet në veri me Komunën Qafë Mali, në jug me Komunën Rrapë, në lindje me komunën Qafë Mali dhe në perëndim me Komunën Qelëz.
Bashkia Fushë-Arrëz shtrihet në një zonë malore, me një sipërfaqe prej 2,360 Ha, pjesa më e madhe e së cilës, 2,274 Ha, është sipërfaqe pyjore. Një pjesë e vogël e territorit të saj administrativ prej 18 Ha përbehet nga qyteti i Fushë-Arrëzit, ndërsa tre fshatrat Fushë-Arrëz, Micoj dhe Lumardhë, zënë një sipërfaqe prej 68 Ha tokë are.

Pasuritë natyrore të Fushë-Arrëzit, kryesisht ato nëntokësore, të shprehura në rezervat e mëdha minerale të shfrytëzueshme për periudha afatgjata, pasuritë mbitokësore, si fondi i pasur pyjor, të kombinuara me një klimë malore të pastër dhe kuruese, janë veçori përcaktuese në llojin e zhvillimit të deritanishëm të Fushë-Arrëzit dhe gjithashtu përparësi që mbështesin zhvillimin në të ardhmen.



Pozicioni gjeografik i Bashkisë Fushë-Arrëz

Qyteti i Fushë-Arrëzit e mori këtë emër nga fshati Fushë-Arrëz në vitet '50, periudhë gjatë së cilës kishte filluar aktiviteti industrial i prodhimit dhe përpunimit të lëndës drusore dhe përpunimit të bakrit, të cilat kanë qenë dhe janë aktivitetet kryesore ekonomike.

Drejtimet dhe Zhvillimet Rajonale

Sfidat e zhvillimit të periudhës 17-vjeçare të transicionit kanë evidentuar nevojën e ripërcaktimit të rolit të Fushë-Arrëzit me synim rritjen e aftësisë së tij për t'u integruar dhe përshtatur me zhvillimet dhe tendencat e shfaqura dhe njëkohësisht për t'iu përgjigjur konkurrencës në kontekstin rajonal më mirë dhe më shpejt.

Në çdo rast, Bashkia e Fushë-Arrëzit nuk mund të konsiderohet e shkëputur nga bashkitë përreth në kuadër të një zhvillimi rajonal në të ardhmen. Në këtë drejtim, duhen mbajtur parasysh thellimi i decentralizimit në vend dhe tendencat drejt rajonalizimit në zhvillimin e ekonomive lokale, pra orientimi rreth elementeve zhvillues të përbashkët ndërmjet njësive të ndryshme vendore.

Aktualisht, Bashkia Fushë-Arrëz identifikon nevojën për harmonizimin e përpjekjeve për bashkëpunim në disa fusha dhe aktivitete potenciale ekonomike, në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të avantazheve të përbashkëta dhe zgjidhjes së problematikave që shkojnë përtej kufijve të saj administrativë.

Zhvillimi i turizmit malor në Fushë-Arrëz, i identifikuar si një potencial ekonomik i rëndësishëm në zona si Krrabë, Munellë etj., si dhe grumbullimi i bimëve mjekësore dhe prodhimeve të dyta pyjore, janë dy sektorë potencialë të cilët mund të shihen të ndërthurur me përpjekje të ngjashme në Pukë dhe në Shkodër.

Nga ana tjetër, disa probleme të caktuara që ekzistojnë në nivel qarku si depozitimi i mbeturinave në përputhje me standardet mjedisore apo mbrojtja e pyjeve dhe ekosistemeve në tërësi, prekin njëkohësisht Fushë-Arrëzin dhe Pukën dhe, për këtë arsye, kërkohen zgjidhje të përbashkëta dhe të koordinuara.

Një zhvillim i rëndësishëm në nivel kombëtar apo rajonal është ndërtimi i rrugës se re (autostradës) Durrës-Morinë. Kjo rrugë vlerësohet se mund të ketë një ndikim jo të favorshëm në perspektivë për Fushë-Arrëzin, pasi do të zvogëlojë trafikun përgjatë rrugës ekzistuese interurbane, i cili është edhe gjeneruesi i aktiviteteve kryesore për Bashkinë.

2.2 Demografia dhe Parashikimet e Popullsisë

Situata aktuale

Fushë-Arrëzi është një qytet i vogël për nga popullsia, me rreth 4,800 banorë, nga të cilët mbi 3,900 banorë jetojnë në qytet dhe pjesa tjetër në fshatra, sikurse paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Ndryshimet apo lëvizjet demografike gjatë periudhës së transicionit pas vitit 1990 nuk kanë qenë të ndjeshme në Fushë-Arrëz; ndërkohë shifra të një popullsie të stabilizuar janë raportuar nga Bashkia. Megjithatë, për sa i përket përbërjes së popullsisë, është vërejtur dukuria e lëvizjes dhe shpërnguljes së banorëve nga qyteti drejt qyteteve të tjera më të zhvilluara ose drejt zonave fushore në përgjithësi.

Kjo tendencë negative për Fushë-Arrëzin është balancuar nga një numër i përafërt njerëzish që janë shpërngulur nga zonat e thella rurale dhe malore përreth duke u vendosur me banim në Fushë-Arrëz.

Përbërja e popullsisë, Fushë-Arrëz (2007)

Nr.	Emërtimi	Nr. i Banorëve	Nr. i Familjeve
1	Qyteti Fushë-Arrëz	3,907	921
2	Fshati Fushë-Arrëz	607	166
3	Fshati Micoj	89	28
4	Fshati Lumardhë	216	60
	Shuma	**4,819**	**1,175**

Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz

Humbja e popullsisë si pasojë e tendencës gjithnjë në rritje të banorëve të Fushë-Arrëzit për t'u shpërngulur drejt zonave perëndimore të Shqipërisë që ofrojnë më shumë mundësi dhe të ardhme ngrihet si një sfidë e rëndësishme e zhvillimit demografik për Bashkinë. Njëherazi, ajo

është shenjë e nivelit të ulët të jetesës dhe e një të ardhmeje të pasigurt në Fushë-Arrëz.

Kjo lëvizje demografike e popullsisë ka prekur veçanërisht burimet njerëzore më të kualifikuara si specialistët dhe intelektualët, por edhe të rinjtë, të cilët ndjekin studimet në Tiranë dhe kanë tendencën për të mos u kthyer në Fushë-Arrëz pas përfundimit të studimeve.

Parashikimet e popullsisë

Përgjatë më shumë se 15 viteve të fundit, Fushë-Arrëzi nuk ka pasur ndryshime të mëdha demografike. Megjithatë kjo periudhë është shoqëruar me një tendencë negative të largimit drejt qyteteve të tjera apo me emigracion, duke çuar në tkurrjen e popullsisë vendase.
Në vijim të konstatimit se kjo tendencë e humbjes së popullsisë është në rënie apo ka përfunduar në Fushë-Arrëz, në përputhje me rënien e lëvizjeve të brendshme migruese në shkallë vendi, parashikohet se në vitet në vazhdim popullsia e Fushë-Arrëzit do të ketë një rritje të ngadaltv por të vazhdueshme.


Një parashikim i thjeshtë i popullsisë i bërë për periudhën afatmesme 2008-2011, sikurse paraqitet nga të dhënat tabelore dhe grafike më poshtë, tregon se Fushë-Arrëzi, në fund të vitit 2011, do të ketë 5,157 banorë gjithsej. Ky shtim përfaqëson një rritje me 538 banorë në krahasim me vitin 2007 ose me 11,6% në total. Rritja do të jetë e shpërndarë mesatarisht në 2.91 për qind çdo vit dhe do të ndodhë në mënyrë të njëtrajtshme si në qytet edhe në fshat.

Parashikimi i ndryshimeve demografike në Fushë-Arrëz (2008-2011)

Viti	Nr. i Familjeve			Nr. i Banorëve		
	Qytet	Fshat	Total	Qytet	Fshat	Total
2008	970	265	1235	3909	912	4819
2009	978	270	1248	3850	980	4830
2010	983	275	1258	3960	1100	5060
2011	989	279	1268	3999	1158	5157

Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz

Të dhënat e tabelës së mësipërme janë paraqitur grafikisht më poshtë.



2.3 Ekonomia

Situata aktuale

Gjatë periudhës së transicionit, Fushë-Arrëzi është përballur me një ekonomi të dobësuar dhe jokonkurruese, nga humbja e burimeve kryesore ekonomike, gjë që ka çuar në humbjen e interesit së investimeve në zonë si dhe në tkurrjen e popullsisë. Gjatë periudhës gjysmëshekullore të regjimit komunist, qyteti i Fushë-Arrëzit u përcaktua dhe u zhvillua si një qendër e vogël industriale, ku industria e përpunimit të drurit dhe uzina e bakrit ishin dy aktivitetet kryesore ekonomike në kuadër të ekonomisë shtetërore të centralizuar.
Mbyllja e këtyre industrive apo sektorëve tradicionalë, ku ishte e punësuar shumica e popullsisë, për shkak të ineficiencës së mbajtjes së tyre në formën e mëparshme të organizimit, solli si rezultat një gjendje të vështirë ekonomike dhe një rritje të numrit të të papunëve në Fushë-Arrëz.



Papunësia është një ndër problemet më të mprehta ekonomike dhe shoqërore të periudhës së transicionit në Fushë-Arrëz. Ajo ka ardhur për shkak të mungesës së investimeve të mjaftueshme, private dhe shtetërore, për nxitjen e zhvillimit të biznesit me qëllim krijimin e një numri të mjaftueshëm vendesh pune për popullsinë vendase. Zhvillimi i sektorit privat në Fushë-Arrëz është i ulët. Në total funksionojnë 80 biznese të cilat janë kryesisht të vogla ose shumë të vogla dhe sigurojnë të ardhura të ulëta.

Burimi kryesor i punësimit për banorët janë uzina e përpunimit të bakrit, me një numër të madh punëtorësh, dhe disa punishte të vjetra dhe të reja për prodhimin e lëndës drusore. Duhet theksuar se gati 26% e familjeve jetojnë me ndihmë ekonomike.

Të dhëna të përgjithshme ekonomiko-financiare

Nr.	Emërtimi	Vlera
1	Familje të regjistruara	1,175
2	Familje me ndihmë ekonomike (mesatarisht)	310
3	Familje që marrin shërbimin e mbledhjes dhe largimit të mbeturinave në qytetin e Fushë-Arrëzit	100 %
4	Numri i bizneseve	80
5	Numri i institucioneve	14

Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz

Tendencat e zhvillimit

Sfida për zhvillimin e Fushë-Arrëzit është e konsiderueshme, duke pasur parasysh raportin e burimeve të mëdha natyrore me strategjitë që janë apo duhen ndjekur në të ardhmen për shfrytëzimin sa më eficient të tyre si edhe vështirësitë që krijohen nga zhvillimi i ulët demografik.



Pamje të zonave të brendshme të qytetit

Bashkia Fushë-Arrëz ka potenciale ekonomike në industrinë e përpunimit të drurit dhe atë të përpunimit të mineraleve, të cilat përfaqësojnë sektorin tradicional industrial; ndërsa perspektivë zhvillimi kanë sektorë të rinj si turizmi malor dhe kultivimi e grumbullimi i bimëve mjekësore, kjo e fundit me një traditë 100-vjeçare. Gjithashtu, pasuritë ujore të Fushë-Arrëzit krijojnë premisa për ndërtimin e një stabilimenti për prodhimin e ujit mineral.

Riorientimi i zhvillimit ekonomik të Fushë-Arrëzit sjell në vëmendje gjithashtu nevojën për një balancim të kujdesshëm midis sektorëve strategjikë që do të kenë më përparësi. Kjo ka të bëjë me përpjekjet për riaktivizimin e industrisë minerare, me rivënien në punë të uzinës së bakrit, me permirësimin e kushteve dhe teknologjisë së saj, e cila në gjendjen aktuale, mund të krijojë efekte negative në nxitjen e turizmit malor.

Një aspekt i rëndësishëm për nxitjen e zhvillimit ekonomik të zonës janë investimet në sektorët e lartpërmendur. Në këtë drejtim, autoritetet vendore, kanë një rol parësot si në planin e orientimit të politikave ashtu edhe në atë të gjenerimit të më shumë të ardhurave nga taksat vendore të cilat të investohen për të përmirësuar infrastrukturën rrugore në funksion të sektorëve të caktuar, si për shembull të turizmit malor, dhe shërbimeve të tjera në përgjithësi. Një strategji afatshkurtër duhet të përcaktojë zonat potenciale për turizëm malor, infrastrukturën e nevojshme dhe gjithashtu hapat administrativë që duhen ndërmarrë për të financuar dhe zbatuar këto infrastruktura.


Teksa ekziston fuqia punëtore si një faktor pozitiv në Fushë-Arrëz, nxitja e aktiviteteve ekonomike, ekzistuese dhe potenciale, duhet përshtatur gjithashtu me kapacitetet teknike dhe intelektuale. Për këtë arsye, është me vend ngritja e shkollave të profilizuara për fushat e turizmit dhe përpunimit të drurit, me qëllimin për të mbajtur dhe punësuar njerëzit në zonë. Këto shkolla mund të shërbejnë edhe për studentë edhe nga zonat përreth Fushë-Arrëzit.

2.4 Financat Bashkiake

Në vitin 1992, në zgjedhjet e para për qeverisjen vendore, është bërë organizimi administrativ në bazë bashkish dhe komunash. Përgjegjësia për menaxhimin financiar është një përgjegjësi e trashëguar, por grumbullimi i të ardhurave vendore dhe menaxhimi i tyre është një përvojë e re për administratën në Fushë-Arrëz.

Situata aktuale

Gjendja dhe ecuria financiare e Bashkisë Fushë-Arrëz në vitet e fundit paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm, bazuar në të dhënat financiare të përftuara nga zyra e financës. Në zbërthimin e buxhetit të periudhës 2005-2008 evidentohen disa probleme të rëndësishme strukturore të cilat prodhojnë efekte negative në punën e institucionit të Bashkisë, të paraqitura si më poshtë:



Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz

- Vëllimi i përgjithshëm i buxhetit, si shumë e të ardhurave të veta të Bashkisë duke përfshirë dhe transfertat nga buxheti i shtetit, karakterizohet nga ulje-ngritje të shpeshta nga viti në vit, gjë që tregon paqëndrueshmërinë financiare të Bashkisë;

- Luhatjet e vazhdueshme e bëjnë të vështirë evidentimin e një tendence të perceptueshme rritëse apo zbritëse të buxhetit. Në krahasim me vitin 2006, që mund të konsiderohet si viti me buxhetin më të madh, viti 2007 ka pasur një rënie të buxhetit total, dhe rikthimi në vlerat e mëparshme parashikohet të rikuperohet në vitin 2008;

- Kontributi nga transfertat e qeverisë qëndrore përbën burimin më të rëndësishëm dhe zë pjesën më të madhe të buxhetit të Bashkisë, në krahasim me të ardhurat e veta. Ky element nxjerr në pah varësinë e theksuar financiare të Bashkisë Fushë-Arrëz, nga fondet e qeverisë qendrore.

- Të ardhurat e veta të Bashkisë gjatë kësaj periudhe, janë pothuajse konstante. Ato nuk kanë pësuar ndonjë rritje apo përmirësim ë dukshëm gjatë periudhës 3-vjeçare. Gjithashtu, ato janë shumë më të vogla në krahasim me transfertat nga buxheti i shtetit dhe rrjedhimisht vëllimin e përgjithshëm të buxhetit të njësisë vendore. Kjo evidenton më tej aftësinë dhe kapacitetin e kufizuar të Bashkisë Fushë-Arrëz në gjenerimin e të ardhurave nga burimet vendore. Niveli i grumbullimit të taksave dhe tarifave është i dobët dhe një ndër arsyet për këtë është koordinimi jo i mjaftueshëm ndërmjet pushtetit vendor dhe organeve përkatëse tatimore.

Një situatë dhe problematikë e ngjashme financiare vërehet në përgjithësi edhe në Bashkitë dhe Komunat e tjera veriore të paraqitura në tabelën e mëposhtme për vitin 2006. Megjithatë, në krahasim me Bashkinë Pukë, e cila ka thuajse të njëjtin numër popullsie me Bashkinë Fushë Arrëz dhe të njëjtat specifika zhvillimi, buxheti për frymë të popullsisë është më i ulët.

Buxheti i përmbledhur për vitin 2006 (në /000 Lekë)

Nr.	Qyteti	Buxheti i përgjithshëm	Të ardhura vendore	Buxheti i shtetit	Popullsia	Buxheti për frymë*
1	Shkodër	**1,509,313**	252,400	1,509,313	112,440	13,423
2	Dajç, Bregu i Bunës	**24,397**	8,054	13,675	8,579	2,843
3	Vau i Dejës	**65,534**	20,249	35,399	12,332	5,314
4	Koplik	**27,480**	11,780	15,700	13,500	2,035
5	Pukë	**43,342**	14,000	28,623	5,450	8,026
6	Fushë-Arrëz	**35,368**	7,500	25,731[1]	4,800	7,493
7	Velipojë	**29,076**	9,000	14,768	8,327	3,492
8	Gur i Zi	**34,688**	8,130	26,558	11,800	2,940

Buxheti për frymë është përllogaritur duke pjesëtuar buxhetin e përgjithshëm me numrin e popullsisë.
Burimi: Vlerësimi Teknik Co-PLAN 2006

Problemi më themelor lidhur me financat aktuale të Bashkisë Fushë-Arrëz është se ato mbeten shumë të pamjaftueshme përballë nevojave për investime publike e strategjike në infrastrukturë e shërbime, me gjithë kontributin e dhënë në mënyrë periodike nga donatorë të ndryshëm. Për pasojë, buxheti aktual është më shumë një plan shpenzimesh i hartuar për të përmbushur nevojat më të ngutshme të Bashkisë, duke mos krijuar hapësirën e nevojshme për t'u angazhuar në një politikë financiare publike efikase.

Shumica e buxhetit të Bashkisë shkon për të mbuluar vetëm pagat e punonjësve të administratës dhe për mirëmbajtjen e infrastrukturës: për shembull, për vitin 2006[3], shpenzimet për administratën (në funksionet e saj) ishin sa transferimet nga buxheti i shtetit dhe pjesa e investimeve ishte sa pjesa e të ardhurave të veta. Ndërkohë, edhe në projekt-buxhetin për vitin 2008, pjesa e buxhetit të Bashkisë e caktuar për investimet është më e vogël se zëri i pagave dhe shpenzimeve operative dhe administrative.

Tendencat e ardhshme

Varësia ekzistuese e buxhetit bashkiak nga transferimet e paparashikueshme të qeverisë qëndrore dhe të ardhurat e vogla të vetë bashkisë nuk favorizojnë një prognozë të saktë dhe realiste të ecurisë financiare për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Për vitin 2008, sipas projekt-buxhetit të paraqitur në tabelën e mëposhtme, parashikohet një rritje e buxhetit thuajse në 4 herë në krahasim me vitin 2007, e cila gjithashtu bazohet më shumë në rritjen e kontributit të shtetit se sa të të ardhurave të vetë bashkisë.

[3] Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz. Vendim nr. 8 datë 29.03.2006 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2006 dhe shpërndarjen e grantit dhe të ardhurave të parashikuara për buxhetin e vitit 2006".

Përmbledhje e të ardhurave të veta të Bashkisë Fushë-Arrëz sipas komponentëve (2005-2008)

FINANCIMET DHE HYRJET	VITI 2005	VITI 2006	VITI 2007	VITI 2008*
TË ARDHURAT				
tatim mbi pasurinë	0	1,200,000	1,262,000	0
tatim mbi ndërtesën	850,000	1,158,000	1,220,000	1,257,000
tatim mbi tokën	42,000	42,000	42,000	43,000
tatim mbi biznesin	3,005,000	3,300,000	3,300,000	3,800,000
të ardhura jotatimore	510,000	450,000	450,000	464,000
taksë pastrimi	800,000	700,000	700,000	0
taksë kalim pronësie	0	0	0	1,300,000
taksë tregu	325,000	250,000	250,000	103,000
taksë regjistrimi	120,000	100,000	100,000	103,000
taksë për therjen e bagëtisë	12,000	10,000	10,000	0
taksë parkingu	100,000	100,000	100,000	0
taksë tabele	60,000	50,000	50,000	52,000
të tjera	435,000	300,000	687,000	1,696,000
të trashëguara	241,000	380,000	400,000	0
SHUMA	**6,500,000**	**7,000,000**	**7,500,000**	**8,000,000**

Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz 2007

Tabela e mësipërme paraqet gjithashtu llojet e taksave vendore që aplikohen dhe ecurinë e vjeljes së tyre nga ana e bashkisë ndër vite, veçanërisht taksës së biznesit dhe taksës së pasurisë. Përmirësimi i të ardhurave vendore nga taksat është kyç për të siguruar një autonomi dhe qëndrueshmëri financiare më të madhe të Bashkisë Fushë-Arrëz, në nivel vendor. Në nivel praktik, kjo nënkupton ngritjen e mëtejshme të burimeve njerëzore të administratës në fushën e taksave, financë-buxhetit e urbanistikës, si dhe pajisjen e Bashkisë me një infrastrukturë dhe logjistikë bashkëkohore në drejtimet e lartpërmendura.

Në nivel kombëtar, përmirësimi i buxhetit të Bashkisë do të varet nga përshpejtimi i procesit të decentralizimit fiskal. Gjithashtu, plotësimet e mëtejshme në kuadrin ligjor së fundmi, do të bëjnë efektiv zbatimin e një marrëdhënieje të re financiare për pushtetin vendor, atë të huamarrjes (kredimarrjes), si një e drejtë e njohur më parë por e pazbatuar ende[4].

[4] Ligji Nr.8652, datë 31.7.2000 shprehet se "Duke filluar nga 1 Janari 2002, komunat, bashkitë dhe qarqet kanë të drejtë të kërkojnë kredi për investime në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë".

2.5 Shërbimet dhe Infrastrukturat Publike

Përmirësimi i infrastrukturave ekzistuese është ndër fushat ku paraqiten nevojat më të mëdha për investime, me qëllim për të ngritur standardin e jetesës së popullsisë dhe njëkohësisht për të siguruar një infrastrukturë të domosdoshme bashkëkohore në shërbim të sektorëve ekonomikë të synuar për zhvillimin ekonomik.

Pothuajse të gjitha infrastrukturat në qytet kanë nevojë të rehabilitohen: rrjetet e ujësjellësit, kanalizimet e ujërave të zeza dhe ujërave të bardha, rrugët etj.; për pasojë, komponenti i infrastrukturave dhe shërbimeve është dhe do të jetë një subjekt i përhershëm i zhvillimit dhe i çdo plani zhvillimi të Bashkisë në vitet në vazhdim.






Ndërkohë që janë realizuar investime të pjesshme nga disa organizata të huaja donatore, financimi i ndërtimit dhe përmirësimit të infrastrukturës mbetet një problem i vazhdueshëm.

2.5.1 Furnizimi me ujë dhe Kanalizimet e ujërave të zeza dhe të bardha

Situata e rrjetit të brendshëm të shpërndarjes është jo e mirë dhe rreth 40 për qind e këtij rrjeti është e konsumuar. Vetëm qyteti i Fushë-Arrëzit ka një rrjet të furnizimit me ujë të brendshëm. Një pjesë e zonave të banimit të fshatrave kanë rrjetet e tyre të furnizimit me ujë, megjithëse në kushte të këqija, ndërkohë që shumë familje furnizohen në burime ujore natyrore dhe një pjesë në puse. Fushë-Arrëzi furnizohet me ujë nga dy burime, ai i Krrabës dhe ai i Micojt, me linja përkatësisht 13 dhe 8 km të gjata, të cilat takohen në një nyjë dhe shkarkohen në të njëjtin rezervuar.



Burimi: Vlerësimi Teknik Co-PLAN 2006

Gjendja e kanalizimeve të ujërave të zeza është gjithashtu e dobët. Rrjeti i kanalizimeve shtrihet vetëm në qytet, ndërsa në fshatra rolin e tij e zëvendëson përdorimi i gropave septike. Të paktën 70 për qind e linjave të tubacioneve kanë nevojë të rikonstruktohet dhe gjithashtu rreth 70 për qind e pusetave janë të konsumuara. Krahas konsumimit të rrjetit, ndryshimet në mënyrën e jetesës së qytetarëve kanë ndikuar edhe në rritjen e sasisë e ujit që përdoret. Trajtimi i ujërave të zeza është një çështje problematike e pazgjidhur ende pasi, në kundërshtim me normat mjedisore, ujërat e zeza shkarkohen direkt në lumë.

Bashkia konsideron si më parësore situatën e furnizimit me ujë të pijshëm, në krahasim me situatën e sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza. Situata e kanalizimeve paraqitet më e keqe, megjithatë konsiderohet si prioritet vetëm në brendësi të zonës urbane (qytetit Fushë-Arrëz), ndërsa në fshatra do të vazhdojnë të jenë në përdorim gropat septike si zgjidhja më e mirë afatgjatë.

Investimet në rrjetin e ujësjellës-kanalizimeve kanë qenë të vazhdueshme, ndërkohë që investime të mëtejshme janë të nevojshme në rrjetin e brendshëm të ujësjellësit me qëllimin për të siguruar shërbim për të gjithë territorin, duke forcuar ndërkohë menaxhimin e Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve. Në harkun kohor 2002-2006, në komponentë të caktuar të rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve, janë kryer investime me vlerë 17.8 milion lekë gjithsej. Në ujësjellësin e Micojt janë kryer disa investime në vitin 2000, ndërkohë që nevojitet rehabilitimi i rreth 50 për qind të ujësjellësit të Krrabës. Një investim i rëndësishëm është edhe projekti për rindërtimin e linjave të ujësjellësit (të rrjetit të brendshëm), i cili parashikohet të mbulojë vetëm qytetin dhe ndoshta fshatin Fushë-Arrëz.

Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me ujë lidhet edhe me burimet njerëzore brenda administratës së Bashkisë ose ndërmarrjes së ujësjellësit. Ndërmarrja e ujësjellësit nuk është ende nën përgjegjësinë e plotë të Bashkisë. Ndërkohë që është kryer transferimi i aseteve të saj, financiarisht ndërmarrja e ujësjellësit varet nga ministria e linjës. Si rrjedhim, Bashkia nuk është përgjegjëse për investime apo punime mirëmbajtjeje në të. Grumbullimi i tarifave të shërbimit të konsumit të ujit është në nivelin 80-

85% nga familjarët dhe 90% nga bizneset. Gjithashtu, një prioritet është edhe instalimi i ujëmatësve.

Rrjeti i ujërave të bardha (të shiut) ka qenë shumë problematik deri në vitin 1992, ku vërshimi i ujërave sillte me vete në qytet shumë materiale inerte. Në vitin 1993, u kryen disa investime të pjesshme në këtë rrjet, nëpërmjet një fondi nga ADF, duke e përmirësuar gjendjen në njëfarë mase.

2.5.2 Rrjeti Rrugor / Infrastruktura rrugore

Gjatësia e përgjithshme e rrugëve në territorin e bashkisë së Fushë-Arrëzit është mbi 15km. Janë gjithsej 11 rrugë fshati, me një gjatësi prej 13,815m, rrugë kombëtare 4,000m dhe rrugë të brendshme në qytet 2,000 metra. Të gjitha këto rrugë janë në përdorim dhe të shfrytëzueshme, megjithatë mirëmbajtja e tyre pothuajse mungon tërësisht. Nga rrugët e brendshme të qytetit, rreth 1,5km janë të paasfaltuara.

Ndriçimi rrugor ekziston dhe funksionon vetëm përgjatë aksit kryesor rrugor në qytet. Në pjesët e tjera të qytetit dhe nëpër fshatra, ky shërbim nuk ekziston.

2.5.3 Transporti Publik

Në Fushë-Arrëz ka katër linja transporti që lidhin konkretisht Fushë-Arrëzin me këto qytete: Shkodër, Lezhë, Durrës dhe Tiranë. Gjithashtu janë të shpeshtë minibusët. Duke qenë se numri i minibusëve të licencuar - 7 gjithsej - nuk e përballon kërkesën për transport, ekzistojnë gjithashtu minibusë të tjerë të palicencuar që operojnë rregullisht.

2.5.4 Mbeturinat Urbane

Në vitin 2007 është miratuar nga Këshilli Vendor i Bashkisë Plani i Menaxhimit të Mbeturinave për qytetin e Fushë-Arrëzit dhe fshatin Fushë-Arrëz. Në kuadër të këtij Plani, janë vendosur rreth 65 kazanë metalikë të rinj përreth qytetit si dhe është vënë në funksionim një makinë teknologjike e re.

Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave urbane në Fushë-Arrëz kryhet 6 herë në javë dhe sasia e mbeturinave ditore është rreth 2-2,5 tonë/ditë.
Mbeturinat hidhen në një pikë të veçantë, të miratuar nga Ministria e Mjedisit, ndërkohë që një nga komponentët që vazhdon të diskutohet është ngritja e një pike të përbashkët depozitimi me Bashkinë Pukë, në territorin e Komunës Rrapaj.

Bashkia dhe lidershipi i saj janë optimistë për përmirësimin e shërbimit, duke u bazuar edhe në të dhënat e grumbullimit të taksës së mbeturinave e cila ka filluar grumbullohej në krahasim me vitet e mëparshme ku thuajse nuk arkëtohej asgjë nga kjo taksë.





2.5.5 Arsimi dhe Kultura

Në fushën e arsimit parashkollor apo arsimit në përgjithësi, pushteti vendor është përgjegjës për kryerjen e këtij shërbimi. Megjithatë arsimi ka një varësi të drejtpërdrejtë nga Drejtoria Arsimore e Rrethit, e cila ndikon në ecurinë e këtij sektori dhe cilësinë e mësimdhënies.

Institucionet arsimore në Bashkinë Fushë-Arrëz përfshijnë gjithsej 4 shkolla në arsimin e detyrueshëm, 3 shkolla nëntëvjeçare me rreth 700 nxënëse.

Në arsimin e mesëm ka vetëm një shkollë të mesme ku studiojnë 300 nxënës. Shkolla e mesme, e cila ndodhet në qytetin e Fushë-Arrëzit dhe është ndërtuar në vitin 1982 e rikonstruktuar në vitin 2004, mbulon një zonë me një popullsi prej 8,000 banorësh edhe përtej kufijve të Fushë-Arrëzit dhe largësia maksimale e fëmijëve nga shkolla arrin në 15 km.

Në nivelin parashkollor, në Fushë-Arrëz ka vetëm një çerdhe, e cila i shërben rreth 25 foshnjave, dhe gjithsej 3 kopshte të shpërndarë një në qytet dhe dy në fshatra, të cilët i shërbejnë rreth 200 fëmijëve. Kopshti i fëmijëve në qytet, i ndërtuar në vitin 1968, mbulon një zonë me një popullsi prej 4,300 banorësh dhe numri i fëmijëve që e frekuentojnë është 130.

Në sektorin e arsimit, investimi më i rëndësishëm kërkohet për rikonstruksionin e përgjithshëm të kopshtit, si institucioni i vetëm që ofron arsimin parashkollor në qytetin e Fushë-Arrëzit. Së fundmi, në Lumardhë është ndërtuar një shkollë fillore dhe një qendër shëndetësore, të cilat funksionojnë në një godinë të përbashkët, me investim nga SDC. Gjithashtu, një kopsht i ri pritet të ndërtohet nga një shoqatë fetare për fëmijët e familjeve në nevojë.

Zhvillimi social dhe kulturor ka një hapësire ende të vogël krahasuar me kërkesat në rritje për një jetë sociale aktive të popullatës. Në Fushë-Arrëz zhvillohet çdo vit aktiviteti kombëtar i festivalit të fëmijëve si dhe konkursi ndërkombëtar i instrumentistëve folklorikë. Ky aktivitet deri më tani është zhvilluar në natyrë dhe ngritja e një qendre kulturore për të rinjtë është një domosdoshmëri për jetën e qytetit.

Financimi i investimit për ngritjen e qendrës së kulturës është mjaft i rëndësishëm pasi kjo qendër do t'u shërbente nevojave të bashkisë së Fushë-Arrëzit dhe të komunave përreth si Gjegjan, Qafë Mali, Blerim, Fierzë dhe Iballë. Megjithatë, investimi ende nuk është zbatuar për mungesë financimi.

Një nga drejtimet e arsimit në Fushë-Arrëz vlerësohet se mund të jetë edhe hapja e një shkolle për turizmin. Mungesa e një shkolle të tillë aktualisht evidentohet në lidhje me synimin për të zhvilluar sektorin e turizmit (malor).

2.5.6 Shëndeti Publik

Për sa i përket qendrave shëndetësore, në Fushë-Arrëz ka tre të tilla, të shpërndara në qytet dhe fshatra. Qendra shëndetësore në qytet është rikonstruktuar dhe është në gjendje të pranueshme, ndërsa qendrat në fshatrat e Micojt dhe Fushë-Arrëzit kanë nevojë për investime. Sigurimi i kujdesit shëndetësor nuk është një përgjegjësi e Bashkisë.

2.5.7 Mjedisi

Gjatë periudhës së transicionit, presioni dhe ndikimi ndaj mjedisit janë rritur ndjeshëm dhe, nga ana tjetër, janë rritur edhe ndërgjegjësimi dhe kërkesat për një mjedis të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm. Megjithatë, zhvillimi dhe mjedisi jo gjithnjë kanë qenë në harmoni me njëri-tjetrin, duke u kushtëzuar nga një sërë faktorësh.

Në Fushë-Arrëz çështja mjedisore është e një ndjeshmërie të lartë, nisur nga ekosistemi natyror i tij. Pasuritë pyjore janë dëmtuar seriozisht si pasojë e shfrytëzimit pa kriter të pyjeve - prerjeve të pakontrolluara masive të tyre gjatë periudhës 15-vjeçare të transicionit - që ndërkohë nuk është shoqëruar me mbjellje të reja.

Kjo situatë rrezikon gjithashtu edhe potencialet në fushën e përpunimit të drurit dhe turizmit. Djegia e sipërfaqeve pyjore gjithashtu thekson rëndësinë e një plani veprimi specifik në lidhje me mbrojtjen e tyre. Fabrikat dhe industria ekzistuese në Fushë-Arrëz zotërojnë një teknologji të prapambetur dhe ndotëse për mjedisin.



Çështje të tjera mjedisore janë ndotja e tokës dhe e burimeve ujore nga mostrajtimi dhe mosmenaxhimi i mbeturinave urbane dhe i kanalizimeve të ujërave të zeza të cilat aktualisht shkarkohen direkt në lumë.

2.5.8 Strehimi

Në Bashkinë Fushë-Arrëz ka gjithsej 321 banesa, nga të cilat 105 ndodhen në qytet, 136 në fshatin Fushë-Arrëz, 38 në fshatin Lumardhë dhe 42 në fshatin Micoj. Numri i apartamenteve/shtëpive është 1,019, nga të cilat 728 janë në qytet, 180 në fshatin Fushë-Arrëz, 57 në fshatin Lumardhë dhe 54 në fshatin Micoj.



Për shkak të shpërnguljes së popullsisë, aktualisht ka një numër të konsiderueshëm shtëpish të pabanuara, gjithsej 130; nga ana tjetër, një numër prej 184 familjesh janë të pastreha. Shumica e të pastrehëve i përkasin familjeve me dy ose më shumë kurora që jetojnë bashkë në një shtëpi. Shumë pak familje janë të pastreha për arsye të tjera siç janë shtëpitë në kushte të papërshtatshme/të rrënuara, të djegura apo të përmbytura.

Një tjetër çështje problematike në lidhje me stokun e banesave është cilësia e tyre. Për shkak të mungesës së mirëmbajtjes nga pronarët si pasojë e mospërballimit të kostove, fasadat e pallateve kanë pësuar dëmtime të konsiderueshme; në mjaft raste, muret prej tulle kanë filluar të dëmtohen, çka kërkon një ndërhyrje të menjëhershme. Megjithëse kjo nuk është një përgjegjësi e pushtetit vendor, është e domosdoshme ndërmarrja sa më e shpejtë e veprimeve konkrete për sigurinë e banorëve.

Problemet e pronësisë në Fushë-Arrëz kanë të bëjnë me mosregjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të një numri të konsiderueshëm të shtëpive ekzistuese nëpër fshatrat e Fushë-Arrëzit të ndërtuara gjatë dhjetëvjeçarëve të kaluar. Pronarët (familjet) në zotërim të këtyre banesave nuk kanë përmbushur vetëdeklarimin ligjor të banesave të tyre për të aplikuar për legalizim, duke krijuar një situatë pronësore të pazgjidhur.

2.5.9 Struktura Hapësinore

Periudha e transicionit ka evidentuar një realitet tërësisht të ri dhe të ndryshëm urban në krahasim me para vitit 1990, duke dhënë ndikime të forta mbi tokën dhe territorin e ndërtuar dhe strukturën hapësinore të qyteteve. Dukuria kryesore e ndeshur në shkallë vendi është se shumica e zhvillimit ka ndodhur në mënyrë të pakontrolluar dhe të parregulluar si duhet, si pasojë e mungesës së një planifikimi minimal të territorit.

Plani i fundit urbanistik (rregullues) i hartuar për Fushë-Arrëzin para vitit 1990 është i paaktualizuar dhe i papërshtatshëm për të udhëhequr zhvillimin e Fushë-Arrëzit. Në kushtet e operimit në sistemin e ekonomisë së tregut, rikthimit të pronësisë private mbi tokën, privatizimit të banesave dhe ndryshimit të rolit të autoriteteve vendore në këtë fushë, për Fushë-Arrëzin parashtrohet nevoja e një planifikimi të ri të territorit, si për pjesën urbane të populluar ashtu dhe zonat e tjera.

Në Fushë-Arrëz nuk janë evidentuar ndryshime të mëdha demografike, sikurse ka ndodhur në pjesë të tjera të vendit nga fluksi i lartë i lëvizjeve

të brendshme migruese duke shkaktuar një problematikë urbane mjaft të rënduar. Si pasojë, problemet urbane në Fushë-Arrëz, për vetë përmasat e vogla të qytetit dhe popullsisë së tij, janë më të minimizuara dhe, në këto kushte, situata urbane dhe planifikimi territorial mund të menaxhohen lehtësisht. Ndërtimet e ngritura pa leje janë të vogla në numër dhe në qytet nuk ka probleme pronësie, sepse në përgjithësi prona i është kthyer pronarit të mëparshëm.

Përgatitja dhe hartimi i planit urban (rregullues) të Fushë-Arrëzit përbën nevojën kryesore për Bashkinë, si instrumenti për të orientuar dhe rregulluar si duhet zhvillimin urban dhe për t'i dhënë një impuls të ri zhvillimit ekonomik të qytetit. Vështirësitë e deritanishme në përgatitjen e një plani nga Bashkia janë mungesa e kapaciteteve institucionale, pengesat ligjore dhe koordinimi institucional me Qarkun në këtë drejtim.

Roli i Bashkisë në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të territorit kushtëzohet edhe nga mungesa e Këshillit të Rregullimit të Territorit (KRrT), si bordi përgjegjës vendimmarrës në nivel lokal për planifikimin.


Së fundi, një element i rëndësishëm në kuadër të transferimit të pronave publike pushtetit vendor[5] është përpilimi nga qeveria i listës së aseteve publike për Bashkinë Fushë-Arrëz, e cila kap shifrën e 38 aseteve në pronësi publike ku përfshihen rrugë, sheshe etj.

[5] Ligji nr.8744, datë 22.2.2001, *"Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore".*



Kapitulli III

Zhvillimi i Ardhshëm i Propozuar i Bashkisë Fushë-Arrëz



Skema e mësipërme paraqet skemën logjike nëpërmjet të cilës lidhet vizioni i zhvillimit të Bashkisë, objektivat kryesore të tij si edhe veprimet konkrete të propozuara. Skema përfshin të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e autoriteteve vendore në Bashkinë Fushë-Arrëz, veçuar sipas sektorëve të ndryshëm, si edhe përcakton veprimet e duhura dhe të nevojshme për t'u marrë në shqyrtim në secilin sektor.

3.1 Vizioni i Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz

Fushë-Arrëzi si një qendër e vogël dhe e ripërtërirë urbane, e përfshirë në realitetin e zhvillimeve të ardhshme rajonale në veri të Shqipërisë; një pikë qëndrimi dhe çlodhëse për njerëzit, aktivitetet e ndryshme ekonomike dhe shërbimet midis Shkodrës dhe Kosovës;

Fushë-Arrëzi si një qytet i ripërtërirë ekonomikisht që mbështetet në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe potencialeve pyjore dhe në turizmin malor.

Fushë-Arrëzi si Bashki me burime njerëzore të kualifikuara, si në nivelin e administratës vendore ashtu edhe në strukturat e sipërmarrjes së biznesit, kulturës, sportit dhe arsimit, që nxisin krijimin e një klime të favorshme për biznesin vendas dhe të huaj dhe mundësitë për punësim e një rritje të qëndrueshme të të ardhurave për banorët;

Fushë-Arrëzi një vend i sigurt, i pastër dhe tërheqës për banorët dhe komunitetet në rritje, të cilët kanë mundësi të përmirësojnë shëndetin dhe mirëqenien e tyre në bashkëveprim dhe me sens qytetar dhe kanë kapacitetin dhe shtysën për të dhënë kontribut efektiv në të ardhmen e bashkisë dhe qytetit.



3.2 Parimet dhe Objektivat e Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz

Dokumenti i Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz duhet të jetë një komponent:

- **Strategjik**, i tillë që të identifikojë ato fusha veprimi afatgjata dhe ndërhyrje konkrete të cilat do të adresojnë nevojat e ngutshme të popullsisë dhe grupeve lokale të interesit, duke i ndërthurur ato me tendencat e zhvillimit në të ardhmen të kësaj bashkie.
- **I thjeshtë dhe i kuptueshëm**, ku propozimet të jenë të qarta për nivelin e vendimmarrjes dhe administratës vendore, banorët, grupet e popullsisë dhe sipërmarrjen private të qytetit, duke mundësuar njohjen dhe konkretizimin e propozimeve në të gjitha fushat e aktivitetit në Bashkinë Fushë-Arrëz.
- **I përshtatshëm**, që të lejojë krijimin e hapësirave të nevojshme për t'u përshtatur ndaj situatave, nevojave apo zhvillimeve të paparashikuara në të ardhmen në Bashki dhe njëherazi subjekt i përmirësimit të vazhdueshëm nga ana e autoriteteve të, duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të grupeve të interesit.

- **I mundshëm**, i tillë që të bazohet në mundësitë reale të Bashkisë Fushë-Arrëz nga pikëpamja financiare dhe e burimeve njerëzore, por pa mënjanuar edhe ato ndërhyrje të rëndësishme strategjike të cilat mund të kërkojnë burime përtej kapaciteteve aktuale të Bashkisë.
- **Transparent**, i tillë që të jetë i hapur me propozimet e tij ndaj të gjithë komunitetit, biznesit dhe grupeve të rëndësishme në Bashkinë Fushë-Arrëz, duke mundësuar kështu rritjen e besueshmërisë në zbatimin e tij dhe rritjen e përgjegjshmërisë së autoriteteve vendore.
- **Aktual**, i përputhshëm me të gjitha strategjitë dhe politikat e tjera të zhvillimit në nivel kombëtar dhe rajonal.

3.3 Drejtimet e Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz sipas Vlerësimit të Komunitetit Lokal

Në dy fazat e para të projektit për përgatitjen e Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz, me pjesëmarrjen e grupit të qytetarëve u identifikuan disa drejtime të mundshme të zhvillimit të zonës, të bazuara në tiparet karakteristike të saj, historikun dhe traditën e mëparshme të ecurisë së zhvillimit por edhe në zhvillimet më të fundit strategjike në nivel rajonal, të cilat do të mund t'i hapin qytetit dhe fshatrave përreth tij një dimension të ri zhvillimi.



Drejtimet kryesore të cilat mund të orientojnë zhvillimin e Bashkisë Fushë-Arrëz në të ardhmen vijojnë si më poshtë:

1. Promovimi dhe zhvillimi i industrisë së përpunimit të drurit duke marrë për bazë pasuritë natyrore pyjore të Fushë-Arrëzit si dhe traditat e zonës.
2. Zhvillimi i Turizmit Malor si një oportunitet i mundshëm për shkak të karakteristikave dhe vlerave natyrore malore që paraqet i gjithë territori i rrethit të Pukës.

Në përputhje me drejtimet e propozuara më lart, qytetarët gjithashtu shprehën vlerësime rreth anëve pozitive që favorizojnë këto drejtime të zhvillimit si dhe rreth anëve negative apo sfidave ekzistuese që duhen trajtuar me qëllim arritjen e objektivave të strategjisë. Në mënyrë të përmbledhur ato mund të kategorizohen si më poshtë:

Anët pozitive:

- Klima dhe pozicioni gjeografik
- Trashëgimia kulturore
- Burimet natyrore
- Masivet pyjore ekzistuese
- Karakteristikat kulturore dhe sociale të komunitetit (mikpritja, toleranca, miqësia)
- Iniciativat e para të biznesit dhe turizmit (rehabilitimi dhe funksionimi i Hotel Turizmit në Fushë-Arrëz)
- Burimet e pasura bujqësore (bimët mjekësore, pemët frutore etj.)

Anët negative (sfidat):

- Infrastruktura e vjetër e ndërtesave dhe mungesa e mirëmbajtjes së tyre
- Rruga Durrës-Morinë e cila do të aneksojë qytetin si aks rrugor kryesor
- "Rrjedhja" e trurit si pasojë e largimit të shtresës intelektuale
- Mungesa e planeve të mëparshme të veprimit dhe zhvillimi sporadik i pastudiuar gjatë viteve '90
- Mentaliteti i bazuar në qëndrimin se përgjegjësia në lidhje me zhvillimin lokal i takon shtetit si strukturë
- Mungesat në infrastrukturën ekzistuese
- Shërbimet publike joefikase
- Mungesa e një plani zhvillimi të qëndrueshëm
- Largimi i vazhdueshëm i popullsisë
- Sistemi i paorganizuar i menaxhimit të mbeturinave urbane dhe mirëmbajtjes së mjedisit



- Mungesa e organizimit të komunitetit për planifikim strategjik dhe përfshirje.
- Mungesa e zhvillimit të biznesit dhe e larmisë së llojeve të tij.

3.4 Objektivat e përgjithshëm të zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz

Bazuar në analizën e përgjithshme të kryer gjatë fazës së parë të projektit, Prill-Qershor 2007, në lidhje me planet dhe strategjitë aktuale kombëtare dhe rajonale të zhvillimit për veriun e vendit si dhe në përfundimet e diskutimeve me ekipin e punës në Bashkinë Fushë-Arrëz, janë identifikuar këta objektiva të rëndësishëm afatgjatë zhvillimi:

A. NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK
Zhvillimi ekonomik i Bashkisë Fushë-Arrëz duke u përqendruar në përmirësimin e klimës së biznesit, promovimin e aktiviteteve lokale të sipërmarrjes dhe krijimin e një mjedisi tërheqës për investitorët e huaj.

B. NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË TERRITORIT
Konsolidimi i qendrës urbane të qytetit të Fushë-Arrëzit si dhe përmirësimi i cilësisë së hapësirave të brendshme urbane në funksion të promovimit dhe zhvillimit të karakterit turistik malor të qytetit.

C. NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE
Rritja e cilësisë së shërbimeve publike dhe infrastrukturës fizike e sociale në të gjithë territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz.

D. NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË QEVERISJES VENDORE
Rritja e kapaciteteve menaxhuese dhe administruese të pushtetit lokal në Bashkinë Fushë-Arrëz.

C. NË FUSHËN E RRITJES SË TË ARDHURAVE VENDORE
Përmirësimi i të ardhurave vendore në Bashkinë Fushë-Arrëz duke rritur kështu mundësinë për investime në të ardhmen.

3.5 Rezultatet e Pritshme dhe Veprimet e Propozuara

3.5.1 Objektivi A. Zhvillimi ekonomik i Bashkisë Fushë-Arrëz

Zhvillimi dhe konsolidimi i aktiviteteve vendore ekonomike në Bashkinë Fushë-Arrëz konsiderohet si elementi më i rëndësishëm i zhvillimit të përgjithshëm të kësaj Bashkie në të ardhmen. Për këtë qëllim, Plani Strategjik i Zhvillimit identifikon qartësisht si më poshtë:

A1. Mbështetjen dhe zhvillimin e prodhimit dhe të aktiviteteve bujqësore vendore

Rezultatet e Pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Evidentimi i potencialeve të prodhimit të këtyre kulturave bujqësore në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz	1. Përgatitja e një studimi teknik ku të evidentohen kapacitetet prodhuese bujqësore në zonën e Fushë-Arrëzit si dhe infrastrukturat përkatëse të nevojshme. 2. Organizimi i forumeve të hapura me fermerët dhe blegtorët e zonës së Fushë-Arrëzit për të stimuluar pjesëmarrjen e tyre në specifikimin e qartë të mundësive të prodhimit të kulturave bujqësore dhe blegtorale.
b. Përmirësimi i përdorimit të tokës dhe infrastrukturave mbështetëse nëpërmjet një studimi për vlerësimin e nevojave për investime	1. Ngritja e një grupi pune të përbashkët (Bashkia, drejtoria e bujqësisë, fermerët) përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e procesit të mbështetjes ndaj zhvillimit të bujqësisë. 2. Organizimi i debateve të hapura apo forumeve lidhur me nevojat dhe prioritetet për investime në sektorin e bujqësisë. 3. Hartimi i një programi/agjende ndërhyrjesh fizike në sistemet e tokave, ujitjes dhe kullimit.
c. Rritja e mbështetjes teknike dhe financiare ndaj fermerëve vendas në Fushë-Arrëz	1. Përcaktimi i një pakete ndihme financiare të përvitshme për fermerët vendas në Bashkinë Fushë-Arrëz me miratimin e Këshillit vendor si dhe vlerësimi i mundësive për financim nga ana e aktorëve të ndryshëm financiarë apo bankave të nivelit të dytë. 2. Përgatitja e projekteve të gatshme teknike për ndërhyrjet fizike në infrastrukturat bujqësore apo në parcelat e kultivuara në Bashkinë Fushë-Arrëz. 3. Lehtësimi dhe mbështetja për ngritjen e kapaciteteve të fermerëve vendas në Fushë-Arrëz me qëllim përmirësimin e eficiencës së tyre në punë dhe prodhimtarisë.

A2. Mbështetjen dhe zhvillimin e Turizmit Malor duke u bazuar në karakteristikat natyrore të veçanta të Bashkisë Fushë-Arrëz

Rezultatet e Pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Nxitja dhe Zhvillimi i aktiviteteve turistike në këtë Bashki	1. Përgatitja e një agjende – programi pune për organizimin e aktiviteteve turistike promovuese në territoret e Bashkisë Fushë-Arrëz. 2. Institucionalizimi i ditëve apo festave të reja ku Bashkia investon për organizimin e festimeve të ndryshme si dhe fton operatorë të ndryshëm ekonomikë për të bashkëpunuar. 3. Përgatitja e materialeve promovuese të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe zonave natyrore me potencial turistik. 4. Ndërtimi i një plani pune të veçantë brenda Bashkisë për përmirësimin periodik të faqes zyrtare në internet.

A3. Promovimin dhe zhvillimin e Aktiviteteve Ekonomike në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz

Rezultatet e Pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Vendosja e bashkëpunimit me komunat fqinje si edhe me Qarkun e Shkodrës me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike	1. Organizimi i takimeve periodike me Qarkun e Shkodrës dhe njësitë e tjera fqinje vendore për të diskutuar rreth mundësive për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në Fushë-Arrëz. 2. Përgatitja e projekteve të përbashkëta midis Qarkut të Shkodrës dhe njësive të tjera fqinje vendore rreth ndërhyrjeve të mundshme në infrastrukturat e nevojshme.
b. Përgatitja e projekteve të detajuara për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike	1. Përgatitja e Studimeve Pjesore të Detajuara. 2. Përgatitja e projekteve teknike të infrastrukturave (ujësjellësve dhe kanalizimeve) në mbështetje të aktiviteteve të reja ekonomike.
c. Mbështetja me investime konkrete	1. Përgatitja e një Plani Pune lidhur me investimet dhe ndërhyrjet fizike. 2. Kryerja e investimeve të vogla vjetore nga ana e Bashkisë Fushë-Arrëz në mbështetje të aktiviteteve ekonomike.

3.5.2. Objektivi B – Menaxhimi i Tokës

B1. Mbrojtja e tokës bujqësore dhe ndalimi i ndërtimeve në të

Praktikisht, në territoret e Bashkisë Fushë-Arrëz nuk janë evidentuar ndërtime në tokat bujqësore me të njëjtin intensitet si në zonat fushore të Qarkut të Shkodrës. Megjithatë, edhe në këtë zonë paraqiten këto karakteristika specifike:

- Mungesa e një kontrolli të kujdesshëm për ndërtimet e reja nga ana e autoriteteve
- Ekzistenca e mentalitetit të gabuar mbi pronën, sipas të cilit pronari mund të bëjë gjithçka me pronën e vet
- Mungesa e Hartave të sakta ku të identifikohet kufiri i zonës së lejuar për ndërtime (vija e verdhë)

Për këtë arsye, Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz propozon marrjen e një sërë masave të nevojshme, si më poshtë:

Rezultatet e Pritshme	Veprime Konkrete të Propozuara
a. Rritja e nivelit të kontrollit mbi ndërtimet e reja (Inspektorati i Ndërtimit) në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz	1. Konsolidimi i zyrës së Inspektoratit të Ndërtimit në Bashkinë Fushë-Arrëz, sipas përcaktimeve të Ligjit të ri Nr. 9780, dt. 16.7.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit". 2. Identifikimi i nevojave për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe logjistike të Inspektoratit të Ndërtimit në Bashkinë Fushë-Arrëz duke qartësuar edhe kërkesat për financime të mëtejshme.
b. Prezantimi dhe konsolidimi i masave penalizuese si dhe njohja e komunitetit lokal me këto masa	1. Përgatitja dhe miratimi në Këshillin Vendor të Bashkisë Fushë-Arrëz i një pakete masash penalizuese për ndërtimet në tokat bujqësore apo ato pyjore nën administrimin e Bashkisë. 2. Përgatitja e materialeve informuese për banorët e Fushë-Arrëzit lidhur me masat që do të merren në rastet e ndërtimeve pa leje të objekteve.

Rezultatet e Pritshme	Veprime Konkrete të Propozuara
c. Identifikimi i politikave fiskale të posaçme për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe pyjeve dhe orientimi i ndërtimeve në këto territore	1. Përgatitja e një vlerësimi teknik i cili të përcaktojë një paketë taksash të posaçme për ndërtimet në territoret bujqësore (dhe në territoret urbane), në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore. 2. Organizimi i trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të stafit të Bashkisë Fushë-Arrëz për të rritur nivelin e grumbullimit të taksës së pronësisë si dhe nivelin e menaxhimit të taksave në përgjithësi e sidomos të taksës mbi pronën.

B2. Rigjallërimi i territoreve ekzistuese të dëmtuara nga aktiviteti njerëzor si dhe mbrojtja e mjedisit në Bashkinë Fushë-Arrëz

Lidhur me mjedisin dhe mbrojtjen e tij, Planin Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz propozon:

Rezultatet e Pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Identifikimi i zonave që kanë nevojë për ndërhyrje përmirësuese në mjedis	1. Hartimi i një studimi teknik hartografik ku të specifikohen zonat e ndjeshme mjedisore në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz si dhe përcaktimi i nevojave për ndërhyrje fizike përmirësuese.
b. Përmirësimi i gjendjes së mjediseve të dëmtuara (ndotura) në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz	1. Pastrimi i zonave urbane të qytetit nga mbeturinat e pagrumbulluara si dhe depozitimi i tyre në pikën aktuale të grumbullimit.


Instrumentat e Menaxhimit te Territorit

Siç është identifikuar edhe në përmbledhjen e profilit të bashkisë, në Kapitullin II, Bashkia Fushe Arrëz ka nje dinamikë të papërfillshme për sa i përket zhvillimeve hapësinore. Rënia graduale e popullsisë, si indikator i zhvillimit të ulët social ekonomik të zonës, shoqërohet në të njëjtën kohë me një kërkesë shumë të ulët për ndërtime të reja, apo transaksione të tokes. Si rrjedhim, propozimet në këtë aspekt janë kufizuar në identifikimin formal të formave të zhvillimit të secilës zonë urbane në qytezën e Fushë Arrëzit, pa marrë në konsideratë fshatrat Micoj dhe Lumardhë. Kjo ndërhyrje është konceptuar si një minimum i domosdoshëm për administratën e Bashkisë Fushë Arrëz për të menaxhuar territoret urbane. Në këtë kuadër, në materialin grafik (shih - Materialet Hartografike) identifikohen:


Zona e rehabilitimit mjedisor: kjo njollë konturon territorin në të cilin shtrihen dampat e derdhjes së mbeturinave të fabrikës së pasurimit të bakrit, e cila sipas perfaqësuesve të Bashkisë ka nevojë urgjente për ndërhyrje përmirësuese dhe rehabilituese.
Zonat ekonomike: ky lloj zonimi identifikon ato territore pranë qytezës së Fushë Arrëzit të cilat mund të akomodojne aktivitete të ndryshme ekonomike, të cilat janë të pozicionuara kryesisht përgjatë rrugës kryesore nacionale, pranë ish zonave ekonomike të sharrave apo magazinave të vjetra.
Zonat rurale: ky zonim identifikon territoret përreth qytezës, rehabilitimi urban i të cilave duhet të paraprihet nga përgatitja e studimeve të pjesshme urbane.
Zonat e Gjelbra: territoret të cilat duhet të ruhen dhe të promovohen gradualisht në hapësira të gjelbra në shërbim të popullsisë lokale të qytezës.

Bashkia Fushë Arrëz, nëpërmjet instrumenteve të menaxhimit të territorit, ka evidentuar hapin e parë drejt studimeve të detajuara, që do t'i nevojiten në të ardhmen për të organizuar territorin e saj si njësi vendore, bazuar në maksimalizimin e burimeve dhe minimizimin e kostove.
Këto instrumente të paraqitura në mënyrë skematike orientojnë studimet e sipërpërmendura në bazë të prioriteteve dhe të planeve të veprimit siç përcaktohen në këtë Plan Strategjik.


PLANI STRATEGJIK BASHKIA
FUSHE-ARREZ
Instrumentat e Menaxhimit
te Tokes
Zone me
Ndotje
Industriale
Fabrika e
Pasurimit te
Bakrit
Kukes


Qendra
e Qytetit
Qyteti i
Fushe Arrezit
Fushe Arrez
fshat
Puke
Lumi Fan
Legjenda
Zonat qe do te Ploteshen me Studime
Urbane & Projektet e Infrastrukturave
(Studime Urbane, Plane Rregulluese, Studime Fjesore, Dizain Urban etj.)
Zonat qe do te Plotesohen me
Studime dhe Projekte Mjedisore
Zonat qe do te jene ne Ngrirje
Zonat qe do te Plotesohen me Projekte te
Detajuara te Dizainit Urban
Akse te Reja te Propozuara
Bashkia Fushe-Arrez
Co-PLAN
Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Albania


PLANI STRATEGJIK
BASHKIA FUSHE-ARREZ
N
KUKES


PUKA
Propozimi per Perdorimin e Tokes
BREZ I GJELBER I QYTETIT
ZONA EKONOMIKE
ZONA TE BANUARA ME KARAKTER RURAL
ZONA URBANE EKZISTUESE
ZONA E DENDESIMIT DHE KONSOLIDIMIT URBAN DHE EKON OMIK
ZONE E REHABILITIMIT MJEDISOR
ZONA E QENDRES
AKSI NACIONAL
FUSHE ARREZ
BASHKIA FUSHE-ARREZ
inter cooperation
Co-PLAN
Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Albania

3.5.3 Objektivi C. – Përmirësimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve Publike

Bashkia Fushë-Arrëz ka përgjegjësinë e drejtpërdrejtë, sipas funksioneve të përshkruara në ligjin shqiptar, për sigurimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturave sociale dhe fizike si dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët e vet.

Duke u bazuar në gjendjen ekzistuese të evidentuar në profilin e Bashkisë, në Kapitullin **II** si dhe në drejtimet e propozuara të zhvillimit të kësaj Bashkie, Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë propozon:

C1. Përmirësimin e gjendjes së rrjetit rrugor në Bashkinë Fushë-Arrëz

Rezultatet e Pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Hartimi i projekteve të ndërhyrjes në rrjetin rrugor të qytetit dhe të fshatrave të Bashkisë Fushë-Arrëz	1. Përgatitja e projekt-propozimeve të posaçme, duke ia adresuar ato donatorëve potencialë, për financimin e procesit të hartimit të Projekteve Teknike në lidhje me ristrukturimin dhe përmirësimet fizike të rrugëve në Bashkinë Fushë-Arrëz. 2. Përgatitja e Detyrave të Projektimit nga ana e Bashkisë Fushë-Arrëz për t'i paraprirë përgatitjes së Projekteve Teknike për akset rrugore prioritare.
b. Kryerja e investimeve përmirësuese për rrjetin rrugor të qytetit	1. Fillimi i punës për rehabilitimin e *bypass*-it të qytetit të Fushë-Arrëzit duke lehtësuar qarkullimin e mjeteve në këtë zonë 2. Përgatitja dhe miratimi i një plani ndërhyrjesh përmirësuese në rrjetin rrugor të qytetit si dhe në të gjithë territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz.

C2. Përmirësimi i gjendjes së ujësjellës-kanalizimeve në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz

Me vendimin e qeverisë Shqiptare për kalimin në pronësi të bashkive dhe komunave të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve në fund të vitit 2007, Bashkia Fushë-Arrëz ka për detyrë konsolidimin dhe përmirësimin e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve në territoret e veta.

Rezultatet e Pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Përmirësimi i kushteve teknike dhe menaxhuese të drejtorisë së Ujësjellës-Kanalizimeve në Bashkinë Fushë-Arrëz	1. Kryerja e një inventari të plotë ku të identifikohen të gjitha asetet fizike dhe kapitalet që disponon Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve në Bashkinë Fushë-Arrëz 2. Përgatitja e një skeme përmirësimi dhe investimi për logjistikën dhe zyrat e Drejtorisë së Ujësjellës-Kanalizimeve në Bashkinë Fushë-Arrëz. 3. Alokimi dhe miratimi në Këshillin Vendor të Bashkisë i financimit për përmirësimin e gjendjes teknike të zyrës së Drejtorisë së Ujësjellës-Kanalizimeve
b. Përmirësimi i gjendjes fizike të rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve në territorin e Bashkisë	1. Përgatitja e projekteve teknike për përmirësimin e rrjeteve të shpërndarjes së ujit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza.
c. Rritja e kapaciteteve të stafit të ndërmarrjes për menaxhimin dhe administrimin e saj	1. Financimi dhe organizimi i trajnimeve të nevojshme për stafin e ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve për përmirësimin e eficiencës dhe shërbimit

C3. Përmirësimi i gjendjes së grumbullimit dhe depozitimit të mbeturinave urbane

Duke qenë se Bashkia Fushë-Arrëz ka një plan menaxhimi të mbeturinave urbane të përgatitur në fillim të vitit 2008, është e nevojshme që ndërhyrjet e propozuara të marrin në konsideratë kriteret dhe përcaktimet e këtij plani.

Rezultatet e Pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Identifikimi i një pike për depozitimin e mbeturinave	1. Hartimi i një studimi teknik për përcaktimin dhe vlerësimin e një vendi për ngritjen e një landfilli inxhinierik për depozitimin dhe trajtimin e mbeturinave urbane në Bashkinë Fushë-Arrëz në bashkëpunim me autoritetet e Bashkisë Pukë dhe me koordinimin e Qarkut Shkodër.

C4. Përmirësimi i gjendjes së shkollave dhe kopshteve në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz

Bazuar në përcaktimet ligjore lidhur me këto funksione, ku Bashkia Fushë-Arrëz është përgjegjëse për mirëmbajtjen fizike të shkollave të mesme dhe nëntëvjeçare, ndërkohë që sistemi i mësimdhënies është nën administrimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Strategjia e Zhvillimit propozon:

Rezultatet e Pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Evidentimi i nevojave për përmirësime fizike në shkollat e Bashkisë Fushë-Arrëz	1. Hartimi i një vlerësimi teknik ku të evidentohet gjendja ekzistuese e shkollave në territorin e Bashkisë dhe nevojat për riparime dhe përmirësime fizike të tyre
b. Përgatitja e projekteve teknike për financime të mundshme nga sektori shtetëror apo donatorë të ndryshëm	1. Përgatitja e projekteve teknike nga ana e zyrës së projektimit në Bashki për formën dhe mënyrat e ndërhyrjeve fizike në kopshte dhe shkolla
c. Nxitja e forumeve lokale lidhur me mundësinë e rritjes së cilësisë së mësimdhënies në shkollat e bashkisë	1. Ngritja dhe konsolidimi i këshillave prindërorë në shkollat e Bashkisë Fushë-Arrëz 2. Organizimi i mbledhjeve periodike për të diskutuar përmirësimin e faciliteteve shkollore në shkollat e Fushë-Arrëzit

C5. Gjelbërimi i mjediseve në Bashkinë Fushë-Arrëz

Rezultatet e Pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Përmirësimi i kushteve fizike të mjediseve të gjelbra në territorin e bashkisë	1. Përgatitja e projekteve teknike për rehabilitimin e gjelbërimit të rrugëve në bashkinë Fushë-Arrëz 2. Përgatitja e projektit teknik për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e zonave të gjelbra dhe kurorave përreth qytetit të Fushë-Arrëzit 3. Organizimi dhe financimi periodik i proceseve të mbjelljes së drurëve përgjatë zonave rrethuese të qytetit

C6. Ndriçimi i rrugëve

Rezultatet e Pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Përmirësimi i gjendjes së ndriçimit rrugor në Bashkinë Fushë-Arrëz	1. Përgatitja e projekteve teknike për rehabilitimin dhe përmirësimin e ndriçimit rrugor përgjatë rrugëve kryesore të qytetit të Fushë-Arrëzit 2. Përmirësimi i ndriçimit rrugor në rrugët kryesore të qytetit

C7. Mirëmbajtja e Varrezave Publike

Rezultatet e Pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Zgjerimi dhe përmirësimi i kushteve aktuale të varrezave publike	1. Sigurimi i tokës për zgjerimin e varrezave publike në qytetin e Fushë-Arrëzit 2. Financimi i gjelbërimit periodik të zonës së varrezave publike

C8. Dekorimi i qytetit

Rezultatet e Pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Përmirësimi i imazhit të qytetit dhe dekorimi i tij	1. Përgatitja e planit vjetor të investimeve lidhur me zbukurimin dhe përmirësimin estetik të zonave publike 2. Organizimi dhe financimi i ndërhyrjeve përmirësuese përgjatë rrugëve kryesore të qytetit

C9. Rritja e shkallës së punësimit në Bashkinë Fushë-Arrëz.

Ky komponent varet nga këta faktorë:

- Rritja e numrit të aktiviteteve të bizneseve lokale
- Rritja e numrit të të punësuarve nëpërmjet projekteve sociale të ndryshëm të financuar nga bashkia apo donatorë të ndryshëm
- Rritja e kapaciteteve profesionale të banorëve të Fushë-Arrëzit duke rritur kështu mundësitë për punësim

Në përputhje me përmirësimin e gjendjes së grupeve të prekura, Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz propozon:

Rezultatet e Pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Rritja e kapaciteteve të banorëve vendas në Bashkinë Fushë-Arrëz	1. Organizimi i kurseve të ndryshme periodike të trajnimeve profesionale për grupet në nevojë në Bashkinë Fushë-Arrëz 2. Përgatitja e projekt-propozimeve të ndryshme për donatorët, për sigurimin e financimeve për projekte të ndryshme të punësimit social për grupe të ndryshme në nevojë në Bashkinë Fushë-Arrëz
b. Organizimi i punësimeve periodike për grupet në nevojë	1. Financimi i projekteve të infrastrukturës në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz ku të angazhohen grupe njerëzish në nevojë

3.5.4 Objektivi D. - Qeverisja e Mirë Vendore

D1. Rritja e kapaciteteve të Bashkisë Fushë-Arrëz

Rezultatet e Pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Riorganizimi administrativ i Bashkisë Fushë-Arrëz	1. Përgatitja e një Analize Institucionale të Bashkisë Fushë-Arrëz duke identifikuar mundësitë e riorganizimit të strukturës administrative të bashkisë në funksion të rritjes së eficiencës së shërbimeve si dhe infrastrukturave publike
b. Rritja e kapaciteteve teknike të stafit të bashkisë	1. Organizimi i trajnimeve periodike për rritjen e kapaciteteve të stafit të Bashkisë Fushë-Arrëz në fushat e menaxhimit të territorit si dhe të shërbimeve publike.

D2. Rritja e transparencës në vendimmarrje

Rezultatet e Pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Shpërndarja zyrtare e informacionit lidhur me aktivitetet e Bashkisë Fushë-Arrëz	1. Përgatitja dhe shpërndarja e gazetës bashkiake Fushë-Arrëz 2. Përgatitja e raportit vjetor për aktivitetet e bashkisë, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara
b. Nxitja e pjesëmarrjes qytetare dhe informimi në mbledhjet e këshillit bashkiak	1. Financimi i ftesave apo njoftimeve lidhur me organizimin e mbledhjeve të këshillit bashkiak në Bashkinë Fushë-Arrëz

D3. Zhvillimi i procesit të buxhetimit me pjesëmarrje në Bashkinë Fushë-Arrëz

Rezultatet e Pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Ngritja e kapaciteteve lokale për organizimin e Buxhetimit me Pjesëmarrje në Fushë-Arrëz	1. Lehtësimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për stafin vendor lidhur me organizimin e procesit të buxhetimit me pjesëmarrje në Fushë-Arrëz
b. Organizmi i aktiviteteve vjetore periodike të Buxhetit me Pjesëmarrje në bashkinë Fushë-Arrëz	1. Financimi i organizimit vjetor të Buxhetimit me Pjesëmarrje në Bashkinë Fushë-Arrëz

3.5.5 Objektivi F. Mobilizimi i Burimeve Financiare dhe Ritje e të Ardhurave

Niveli i të ardhurave në Bashkinë Fushë-Arrëz është në nivele të tilla të ulëta që nuk përballon nevojat për investime që ka kjo njësi në infrastruktura dhe shërbime. Aktualisht Bashkia ka në programin e vet një plan investimesh në infrastruktura të cilat mbulojnë thuajse të gjitha akset rrugore ekzistuese si dhe infrastrukturat bazë. Në përputhje me këto projekte, Plani Strategjik i Zhvillimit propozon:

F1. Rritjen e të ardhurave vendore të Bashkisë Fushë-Arrëz

Rezultatet e Pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Krijimi dhe konsolidimi i bazës së të dhënave për rritjen e bazës së taksave dhe tarifave në Bashkinë Fushë-Arrëz	1. Ngritja e një grupi pune në Bashkinë Fushë-Arrëz për përpilimin dhe ngritjen e një Baze të Dhënash për krijimin e një liste të bizneseve, pronave dhe familjeve si aktivitete ekonomike taksapagues 2. Ngritja e një Sistemi Informacioni në Bashkinë Fushë-Arrëz nëpërmjet të cilit të evidentohen ndryshimet dhe përmirësimet në politikat fiskale në lidhje me bizneset dhe pronat (troje dhe tokë bujqësore) në funksion të rritjes së të ardhurave lokale

F2. Promovimin dhe rritjen e investimeve të vendit dhe të huaja

Duke u bazuar në potencialet dhe drejtimet e zhvillimit të përcaktuara në fillim të Kapitullit III të këtij dokumenti, për rritjen e investimeve vendore dhe të huaja është e nevojshme që:

Rezultatet e Pritshme	Ndërhyrje Konkrete të Propozuara
a. Përgatitja e materialeve promovuese për Bashkinë Fushë-Arrëz	1. Krijimi i një materiali të plotë (Profili i Bashkisë) ku të evidentohen të gjitha vlerat dhe karakteristikat specifike natyrore dhe njerëzore të Fushë-Arrëzit dhe mundësitë për investime, të shoqëruara me materiale hartografike dhe fotot përkatëse. 2. Krijimi dhe konsolidimi i faqes së Internetit të Bashkisë Fushë-Arrëz
b. Organizimi i evenimenteve të ndryshme në mbështetje të biznesit në Bashkinë Fushë-Arrëz	1. Organizimi i konkurseve dhe panaireve në nivel rajonal ku të ftohen biznese dhe sipërmarrës të ndryshëm si dhe të promovohen mundësitë dhe potencialet për investime në këtë Bashki

F3. Evidentimin dhe shfrytëzimin e burimeve të tjera financiare për Bashkinë Fushë-Arrëz

Rezultatet e Pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Përgatitja e projekt-propozimeve	1. Ngritja dhe konsolidimi brenda strukturës së administratës së Bashkisë Fushë-Arrëz të një zyre të posaçme për hartimin e projekt-propozimeve ndaj donatorëve apo investitorëve të ndryshëm 2. Përgatitja e një pakete Projekt-Propozimesh të cilat adresojnë si përmirësimin e infrastrukturave dhe shërbimeve ashtu edhe rritjen e investimeve në territorin e Bashkisë.

Një mundësi e mirë për Bashkinë Fushë-Arrëz janë financimet që mund të sigurohen në kuadër të IPA (*Instruments for Pre-Accesssion Assistance*) që është një program për të asistuar vendet që aspirojnë të hyjnë në Bashkimin Evropian. Programi IPA ka një shtrirje kohore prej 2007 deri në 2013 dhe qëllimi kryesor i tij është që të rrisë eficiencën dhe koherencën e fondeve të dhëna për asistencë, brenda një kuadri bazë, të njëjtë për të gjitha vendet aspirante.

Shqipëria është një nga vendet potenciale për kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Programi IPA përbëhet nga 5 komponentë bazë që janë:

1. mbështetja për procesin e transicionit dhe të rritjes institucionale
2. bashkëpunimi ndërkufitar
3. zhvillimi rajonal
4. zhvillimi i burimeve njerëzore
5. zhvillimi rural

Siç vihet re, pjesa më e madhe e komponentëve të programit është tepër relevante për kontekstin e zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz. Për këtë arsye, administrata vendore duhet që t'i paraprijë proceseve duke rritur kapacitetet e saj dhe nivelin e informacionit për sa i përket këtij programi dhe mundësive që ai paraqet. Kriteret e programit krijojnë për administratën e Bashkisë premisa të mira për financime të mundshme, të cilat duhen hetuar.

Për më tepër, është e rëndësishme që të bëhet një vlerësim i kujdesshëm i mundësive të bashkëpunimit në sfera të ndryshme midis njësive të tjera vendore me Bashkinë Fushë-Arrëz, duke u fokusuar në mundësinë e tërheqjes së financimeve nga fonde dhe programe të reja të Bashkimit Evropian për zhvillimin vendor dhe rajonal. Është e nevojshme gjithashtu që të vlerësohet mundësia e krijimit të "shoqatave funksionale", për qëllime të ndryshme si p.sh.: menaxhimi i mbetjeve, furnizimi me ujë, sistemet e kanalizimeve etj.

Mundësi të tjera për financim për Bashkinë Fushë-Arrëz përfshijnë grante dhe programe të pritshme nga Bashkimi Evropian, fonde të ADF, Fonde të Granteve Konkurruese etj.. Administrata e Bashkisë ka për detyrë që të rrisë kapacitetet e saj nëpërmjet trajnimeve apo ekspertizës teknike për të adresuar sa më shumë financime në territorin e vet.



Kapitulli IV

Zbatimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të propozuar për Bashkinë Fushë-Arrëz

4.1 Ndërhyrjet Institucionale të Propozuara

Bashkia Fushë-Arrëz, nëpërmjet Kryetarit dhe administratës vendore, është përgjegjësja kryesore për zbatimin e Planit. Për të rritur eficiencën e këtij procesi është e nevojshme marrja e masave si më poshtë:

- Ngritja e grupit të zbatimit dhe monitorimit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz, brenda strukturës administrative ekzistuese, i cili do të jetë përgjegjësi kryesor për koordinimin dhe zbatimin e nismave dhe aktiviteteve të propozuara në Planin e Veprimit. Në varësi të buxhetit të Bashkisë, grupi mund të përbëhet nga përfaqësues të zyrave të ndryshme të administratës apo edhe nga specialistë të angazhuar rishtazi në këtë strukturë. Në të dy rastet, grupi duhet të jetë nën lidershipin e kryetarit të Bashkisë. Në këtë mënyrë sigurohet vazhdimësia dhe lidhja e Planit Strategjik të Zhvillimit me proceset e planifikimit dhe buxhetimit vjetor.

- Konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Departamentit të Koordinim Zhvillimit në Bashkinë Fushë-Arrëz, i cili do të angazhohet me përgatitjen e studimeve dhe projekt-propozimeve të nevojshme për financim në funksion të aktiviteteve të propozuara sipas çdo fushe.

- Riorganizimi administrativ i Bashkisë Fushë-Arrëz duke u bazuar në veprimet dhe kërkesat e identifikuara në Planin e Veprimit të propozuar si, krijimi i grupeve të punës për përgatitjen e projekt-propozimeve, organizimi dhe monitorimi i seminareve apo takimeve me pjesëmarrjen e aktorëve vendorë për çështje të buxhetimit, arsimit, bujqësisë, mjedisit etj; organizimi dhe moderimi i "shoqërive funksionale" në bashkëpunim me njësitë vendore fqinje etj..

- Fokusimi në forcimin e strukturave administrative që merren me ndjekjen e angazhimeve strategjike në kuadër të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe monitorimin e performancës.

- Përmirësimi i bazës së të dhënave territoriale, financiare dhe infrastrukturore në Bashki për t'i paraprirë përgatitjes së një serie projektesh apo studimesh të nevojshme për zbatimin e mundshëm të Planit Strategjik të Zhvillimit.

- Rritja e kapaciteteve dhe e nivelit të angazhimit të stafit të Bashkisë Fushë-Arrëz sidomos në aspektin e menaxhimit dhe monitorimit të territorit dhe infrastrukturave fizike nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme apo edhe përmirësimit të sistemit të raportimit dhe vlerësimit.

- Institucionalizimi i raporteve periodike të çdo zyre të administratës lidhur me ecurinë e zbatimit të Planit Strategjik të Zhvillimit.

4.2. Plani i Veprimit – Bashkia Fushë-Arrëz

4.2.1. Plani i Veprimit – Viti 2008

Objektivat e Zhvillimit	Kodi	Veprimet e propozuara	Aktorët Përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
